



RAPORTI I PERGJEGJSHMERISE SOCIALE TE KORPORATES

CORPORATE SOCIAL RESPONSIBILITY REPORT

**2006**





ESHTE MIRE  
TE JESH I PARI





Shëndet - Health

Arsim - Education

E Ardhmja - Future

Punonjësit - Employees

Ekonomi Lokale - Local Economy

Strategji - Strategy

Mjedis - Environment

## PËRMBAJTJA:

### TABLE OF CONTENTS:

---

Fjala e Drejtorit Ekzekutiv

Words from the Chief Executive Officer

1. Profili i kompanisë  
Company Profile
2. Strategjia e kompanisë  
The Company Strategy
3. Aktorët kryesorë: punonjësit tanë  
The Key-Players: Our Employees
4. Telefoni celulare e një cilësie ndërkombëtare  
World-Class Mobile Telephony Operations
5. Investimet tona në ekonominë e vendit  
Our Investment in the Local Economy
6. Investimet tona në shoqëri dhe mjedis  
Our Investment in the Society and the Environment
7. Vizioni ynë për të ardhmen  
Our Vision for the Future





**AMC synon përsosmërinë. Si pjesë e grupit COSMOTE,** lider në fushën e telekomunikacionit në Evropën Juglindore, ne jemi të përkushtuar të ofrojmë nëpërmjet risive teknologjike, komunikim të vazhdueshëm dhe të prekshëm nga të gjithë. AMC, duke qenë kompania numër një e telefonisë celulare në vend, është njëkohësisht edhe një nga aktorët më të mëdhenj ekonomikë në tregun shqiptar. Përgjegjësia që na takon, bëhet kështu një udhëzues për kujdesin që duhet të tregojmë ndaj mënyrës se si ne e ushtrojmë biznesin tonë.

Në një kohë kur pothuajse çdo qytetar në Shqipëri zotëron një telefon celular, ky aparat po transformohet çdo ditë e më tepër në një mjet, i cili ofron shërbime të shumëllojshme. Sfida që paraqet ky zhvillim është e madhe. Ajo konsiston në krijimin e një aksesit të pakufizuar ndaj një shërbimi themelor, jo vetëm duke mundësuar komunikimin ndërmjet individëve, por edhe duke lehtësuar

**At AMC we are dedicated to excellence. As part of COSMOTE,** the leading telecommunications group in South Eastern Europe, we are also committed to our strategy to provide seamless and affordable telecommunication through technological innovation. Consequently, AMC stays unyielding to its number one position in Albania being one of the largest economic players in the Albanian market today. The responsibility we are vested with, therefore, becomes a benchmark of the way we do business.

With almost every Albanian possessing a mobile phone, this service is being transformed day by day into a multimedia, multi-service terminal. This evolution represents a major challenge: providing unlimited access to an essential service, not only in making communication between individuals possible, but also for spreading information through new means of exchange.

përhapjen e informacionit nëpërmjet mjeteve të reja të komunikimit.

Ne i kemi kushtuar seriozitetin e duhur kësaj përgjegjësie, për shkak të impaktit të saj ekonomik, social dhe mjedisor. E bëjmë këtë, sepse misioni ynë është një përpjekje afatgjatë për t'u ofruar klientëve tanë mjetet më të reja, më efektive dhe më të besueshme të komunikimit. E bëjmë këtë, teksa u ofrojmë një jetë cilësore bashkëpunëtorëve dhe familjeve të tyre, duke u integruar në mjedisin natyror dhe social që na rrethon.

Programi ynë i Përgjegjshmërisë Sociale është pjesë e kontributit tonë për zhvillimin dinamik të shoqërisë shqiptare të shekullit XXI. E vetëdijshme se mirëqenia dhe zhvillimi shoqëror janë të pandashëm, AMC ka ndërmarrë nisma të shumëllojshme në favor të mjedisit dhe shoqërisë në tërësi. Duke u ofruar mbështetje financiare njerëzve në

We take this responsibility seriously because of its economic, social and environmental impacts. We do this because our mission is a long-term effort to offer our customers the most innovative, effective and reliable means of mobile communications possible. We do this while ensuring quality of life for our co-workers and their families, integrating ourselves more effectively into our natural and social environment.

Corporate Social Responsibility is part of our contribution to the dynamic Albanian society of the 21st century. Acknowledging that social prosperity and its growth and development are inseparably linked, AMC has undertaken brave initiatives to benefit society as whole and the environment. By offering financial support to people in need, by caring through tangible and intangible initiatives in culture, education, health and social welfare, care of the

nevojë, nëpërmjet një sërë projektesh në kulturë, arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, duke u kujdesur për mjedisin, si dhe duke mbështetur sportistët dhe artistët tanë më të talentuar, AMC po e shtrin vazhdimisht rolin e saj në përmirësimin e jetës së qytetarëve shqiptarë.

Në ngritjen e strategjisë sonë të Përgjegjshmërisë Sociale për vitin 2006, kemi dashur më shumë se kurrë të përqafojmë këtë nismë, këtë mision, si dhe ta vëmë atë në thelb të aktiviteteve tona të përditshme. Për të realizuar këtë ne po përmirësojmë rrjetin e telekomunikacioneve duke ofruar produkte dhe shërbime gjithnjë e më cilësore. Kjo kërkon vendosjen e përgjegjshmërisë dhe etikës në qendër të veprimtarisë sonë, për të pasur një përfitim mbarë shoqëror. Në AMC, ne besojmë se nisma të tilla i hapin rrugën pjesëmarrjes sonë të mëtejshme në shoqërinë shqiptare, pjesëmarrje kjo, e cila shkon krahas me përkushtimin tonë ndaj përsosmërisë.

environment and by supporting the most talented athletes and artists, AMC is continuously expanding its role in improving the lives of Albanian citizens.

In developing our social responsibility strategy in 2006, we wanted more than ever to embrace this undertaking, this mission, into the heart of our everyday activities. To achieve this we are developing a superior quality network combined with improving products and services into our portfolio. This requires placing responsibility and ethics at the basis of our commercial activities for collective benefit. At AMC we believe that such initiatives pave the way for further and more in-depth participation in the Albanian society, a participation which goes hand in hand with our commitment to excellence.

Stefanos Oktapodas

## Profili i Kompanisë Company Profile

### AMC - Një histori suksesi

AMC, operatori i parë GSM në historinë e telekomunikacionit shqiptar, ka lëshuar sinjalin e parë në vitin 1996. Me vetëm 15,000 klientë në vitin 1999, AMC ka bërë hapa gjigantë për zgjerimin e numrit të tyre, duke u kthyer kështu në një nga kompanitë më të suksesshme në Evropën Juglindore. Privatizimi me sukses në vitin 2000, shënoi momentin vendimtar në historinë e saj. Kur COSMO-HOLDING ALBANIA bleu 85% të kapitalit të AMC, kjo e fundit u bë pjesë e grupit COSMOTE. Me një zhvillim dinamik në të gjitha nivelet, AMC mban sot vendin e parë në tregun shqiptar të telekomunikacioneve me më shumë se një milion abonentë; mbulim territori në masën 85%; mbulim popullsi prej më shumë se 98.4%, si dhe zotëruese e 51.5% të tregut të telefonisë së lëvizshme. Rritjet financiare të AMC-së janë një tregues i fortë i suksesit të kompanisë. Që nga viti 2000, AMC i ka shtuar të ardhurat vjetore në afërsisht 6 herë më shumë, duke respektuar njëkohësisht të gjitha standardet e BE-së e legjislacionin shqiptar dhe duke ofruar produkte e shërbime të një cilësie të lartë dhe me çmime të arsyeshme.

#### PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE FINANCIARE

Shuma në milion €	2006
Të ardhura	151,0
EBITDA	91,0
<b>Norma EBITDA</b>	<b>60.3%</b>
Të ardhurat bruto	68,0
Tatimi mbi të ardhurat	18,1
Të ardhurat neto	49,9
<b>Norma e të ardhurave neto</b>	<b>33.0%</b>

Të ardhurat e AMC-së për vitin 2006 ishin 9.7% më të larta se një vit më parë, duke arritur shifrën 151 milionë Euro. Kjo erdhi si rezultat i një rritjeje të numrit të abonentëve prej 26.7%, e cila konsolidoi më tej pozicionin kryesues të kompanisë në treg. Vit pas viti, EBITDA e AMC-së është rritur me 10.2%, ndërkohë që të ardhurat neto janë rritur me 20.3%, me normë të të ardhurave neto që arriti 33%, krahasuar me 30.1% të vitit të kaluar.


### AMC - A story of Success

AMC, the first GSM operator in Albanian telecommunication history, emitted its first signal in 1996. Counting merely 15000 customers in the year 1999, AMC made giant leaps to increase its customer base and grew to become one of the most successful companies in South-east Europe. Its successful privatization in 2000 was the real turning point in its history. At that time, AMC became a subsidiary of COSMOTE when COSMO-HOLDING ALBANIA acquired 85% of its capital. With an impressively dynamic track record at all levels, AMC today holds the leading position in the Albanian market with more than one million subscribers, a territory network coverage of 85%, a population coverage of more than 98.4% and with a market share of 51.5%. AMC's financial growth is a strong indicator of the company's overall success. Since the year 2000 AMC has increased total revenue by nearly six fold all while adhering to EU standards and Albanian legislation and providing top-quality products and services at affordable prices.

#### SUMMARY FINANCIAL RESULTS

Amount in € million	2006
Revenues	151,0
EBITDA	91,0
<b>EBITDA margin</b>	<b>60.3%</b>
Gross income	68,0
Income taxes	18,1
Net income	49,9
<b>Net Income margin</b>	<b>33.0%</b>

AMC's revenues for 2006 were 9.7% higher than the year before reaching €151 million. This was the result of a 26.7% increase in its subscriber base which further consolidated the company's leading market position. Year on year AMC's EBITDA grew by 10.2% while net income increased by 20.3%, with the net the income margin hitting 33% compared to 30.1% in the previous year.



Rritja e shpejtë dhe e vazhdueshme e numrit të abonentëve është një tregues i performancës së shkëlqyer të shërbimeve të AMC-së për afrimin e klientëve. Gjatë viti 2006, AMC ka regjistruar një rritje të dukshme të numrit të klientëve, siç vihet re edhe nga rritja mesatare vjetore prej 27%. Kjo rritje e ndjeshme është një tregues i qartë i preferencës dhe besimit gjithnjë e më të madh që klientët kanë tek kompania dhe ofertat e saj konkurruese. 32 pika shitjeje të AMC-së të shtrira në të gjithë vendin ofrojnë asistencë dhe kujdes profesional për të gjithë qytetarët.

Nëpërmjet marrëveshjeve me 247 operatorë celularë në 101 vende të ndryshme, AMC ofron shërbime roaming për abonentët shqiptarë që udhëtojnë jashtë vendit dhe vizitorët që vijnë në Shqipëri. Vetëm gjatë vitit 2006, AMC ka investuar 23,933,888 €, pothuajse dyfishin e shumës së harxhuar në vitin 2000.

	FY-05	Q1-06	H1-06	9m-06	FY-06
Totali i numrit të klientëve	781,496	827,524	849,466	900,965	990,279

AMC është gjithashtu një nga kontribueset kryesore në buxhetin e shtetit duke paguar taksa dhe TVSH në një shumë prej 155 milionë Euro, si dhe një kontribut në taksa direkte prej 34,091,434 Euro. AMC kryeson gjithashtu duke u renditur në vend të dytë për sa i përket punësimit në vend, me 532 punonjës, të cilëve u ofrohen standarde të burimeve njerëzore të barabarta me ato të punonjësve evropianë.

#### Kontributi në taksat direkte (në €)

2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
10,009,074	13,397,316	33,057,697	29,237,415	27,730,035	33,467,762	34,091,434

#### Kontributi i sigurimeve shoqërore (në €)

2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
86,078	192,777	365,472	519,859	579,062	706,478	989,338

Si kompania numër një e telefonisë celulare në Shqipëri, AMC ofroi e para shërbimet SMS, MMS, GPRS dhe internetin nëpërmjet GPRS-së në vend. Për vite me radhë, AMC është konsideruar kompania më e suksesshme në Shqipëri dhe një

The continuous increase of mobile telephone users year after year points to the excellence of AMC services in attracting and retaining valuable customers. During 2006, AMC registered significant subscriber growth, as demonstrated by the 27% increase in its customer base on a yearly basis. This remarkable growth is a clear indicator of the Albanian consumers' continuously increasing preference and confidence in the company and its competitive offerings. Thirty-two AMC branded points of sale have spread across the country offering professional, personalized care and assistance to all citizens.

Through agreements with 247 mobile operators in 101 countries, AMC provides roaming services to Albanian subscribers traveling abroad and visitors to Albania. In 2006 alone AMC invested 23,933,888 €, almost double the amount that it spent in year 2000.

	FY-05	Q1-06	H1-06	9m-06	FY-06
Total Customer base	781,496	827,524	849,466	900,965	990,279

AMC is also one of the largest contributors to the Albanian state budget contributing taxes and VAT of 155 million Euros to the state coffers plus a contribution of 34,091,434 Euros to direct taxes. AMC also leads the way by being the country's second largest employer currently with a workforce of 532 employees all provided with human resource standards equal to European workers.

#### The contribution to direct taxes (in €)

2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
10,009,074	13,397,316	33,057,697	29,237,415	27,730,035	33,467,762	34,091,434

#### The contribution to social security (in €)

2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
86,078	192,777	365,472	519,859	579,062	706,478	989,338

Being the frontrunner in Albanian telecommunications, AMC was the first to introduce the SMS, MMS, GPRS and Internet through GPRS services in Albania. For several years AMC has been considered the most successful company in Alba-

nia and one of the most successful in Europe. In 2005 AMC was designated the most successful company in South East Europe by OECD.

Në tetor 2005, AMC iu bashkëngjiti imazhit të ri të Grupit COSMOTE – operatori celular me shtrirjen më të gjerë në Evropën Juglindore. Me pothuajse 11 milionë abonentë në Greqi, Shqipëri, Bullgari, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Rumani, COSMOTE tashmë i shërben një popullsie prej 46 milionë banorësh, nëpërmjet kompanive të saj, COSMOTE Greqi, AMC, GLOBUL, COSMOFON, dhe COSMOTE Rumani. Numri i abonentëve të grupit COSMOTE e ka kaluar shifrën prej 11 milionë, duke shënuar një rritje prej 35.4% krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat e Grupit për vitin 2006 arritën shifrën 2,382.3 milionë Euro, një rritje prej 32.5% nga viti 2005, ndërsa EBITDA arriti një rekord prej 876.2 milionë Euro dhe të ardhurat neto kapën shifrën 360.5 milionë Euro.

Në përputhje me vizionin dhe parimet e Grupit COSMOTE, AMC mbështetet në objektivat strategjike të mëposhtme:

- Të ruajë pozitat kryesuese në treg.
- Të nxisë rritjen e kohës së bisedës dhe përdorimin e shërbimeve me vlerë të shtuar si dhe të rrisë përqindjen e të ardhurave
- Të krijojë një model të vendit të punës, për sa i përket cilësisë dhe efikasitetit.
- Të dallohet mbi konkurrentët në të gjitha drejtimet
- Të rrisë kapitalin dhe të shtojë të ardhurat për aksionerët

Ndërkohë që mbron parimet bazë të saj:

- Burimet njerëzore janë aset i ynë më i vlefshëm
- Kontributi i gjithsecilit është themelor për zhvillimin e mëtejshëm të AMC-së
- Përparim dhe vlerësim
- Besueshmëri dhe transparencë
- Përpjekje e vazhdueshme për përmirësim
- Shkëmbim i njohurive
- Përdorim racional i burimeve
- Politika të orientuara drejt klientit
- Rritje e Përgjegjshmërisë Sociale.

In accordance with COSMOTE's visions and values AMC focuses on the following strategic objectives:

In October 2005 AMC adopted the new corporate image of COSMOTE Group – the mobile operator with the widest presence in South Eastern Europe. With almost 10 million customers in Greece, Albania, Bulgaria, F.Y.R.O. Macedonia and Romania, COSMOTE today serves a market of 46 million people, through its companies, COSMOTE Greece, AMC, GLOBUL, COSMOFON and COSMOTE Romania. COSMOTE Group's customer base has exceeded 11 million, a 35.4% increase from a year ago. The Group's revenues for the year 2006 reached 2,382.3 million Euro, a 32.5% increase from 2005, while EBITDA reached a record 876.2 million Euro and the net income reached 360.5 million Euro.

In accordance with COSMOTE's visions and values AMC focuses on the following strategic objectives:

- Sustain leadership in market share and profitability
- Enhance voice usage, stimulate VAS and increase the percentage of revenues
- Establish a model 'work-place' organization, in terms of quality and efficiency
- Differentiate itself from competition on all fronts
- Optimize capital structure and increase returns to shareholders

While defending its core values:

- AMC's human resources are our most valuable asset
- Everyone's contribution is essential to AMC's future growth
- Advancement and Reward
- Credibility and Transparency
- Continuous effort for improvement
- Exchange of knowledge
- Rational use of resources
- Customer centric approaches on all fronts
- Increased social responsibility

## Elementët Kyç të Drejtimit në AMC Key Elements of Corporate Governance at AMC

### Këshilli Mbikqyrës

Këshilli mbikqyrës mbledhet 4 herë në vit dhe mbikqyr aktivitetet e Bordit të Drejtorëve.

1. Konstandinos Liamidis	Kryetar
2. Georgios Tsonis	Zv/Kryetar
3. Igli Daka	Anëtar

### Bordi i Drejtorëve të AMC-së

Bordi i drejtorëve mbledhet çdo muaj dhe mbikqyr gjithë aktivitetin e kompanisë.

Evangelos Martigopoulos	Kryetar
Elias Fotiadis	Zv/Kryetar
Stefanos Oktapodas	Drejtor Ekzekutiv
Nikolaidi Irene	Anëtare
Mavrogalos Spyros	Anëtare

- Drejtori ekzekutiv është përgjegjës për menaxhimin operacional.

AMC përpiqet të ofrojë gjithnjë produkte dhe shërbime cilësore. Nëpërmjet biznesit të telefonisë celulare, AMC do të vazhdojë të japë kontributin e saj për shoqërinë dhe ekonominë ku ajo zhvillon aktivitetin e saj. Vetëm në partneritet me qytetarët shqiptarë, AMC do mundet të arrijë qëllimet e saj vizionare, të ruajë pozicionin e saj si lider në tregun e telefonisë celulare në vend, si dhe të sigurojë pozitat e një konkurenti të vërtetë në tregun botëror.

### Supervisory Board

Supervisory Board meets 4 times per year and supervises the activities of the Board of Directors.

1. Konstandinos Liamidis	Chairman
2. Georgios Tsonis	Vice Chairman
3. Igli Daka	Member

### AMC's Board of Directors

The Board of Directors meets on monthly bases and supervises total activity of the company.

Evangelos Martigopoulos	Chairman
Elias Fotiadis	Vice Chairman
Stefanos Oktapodas	Executive Director
Nikolaidi Irene	Member
Mavrogalos Spyros	Member

- Chief Executive Director assumes the primary responsibility for the operational management.

AMC strives to achieve quality in all that it does. Through the mobile telephone business, AMC hopes to continue its contribution to the society and the economy where it operates. It is only in partnership with the citizens of Albania that AMC will be able to achieve its visionary goals and maintain its leading position in the country's mobile telephone market and assure its position as a true competitor in the global market.





## 2 Strategjia e Kompanisë The Company Strategy

### Strategjia e Kompanisë

#### Parimet e Përgjegjshmërisë Sociale

AMC erdhi në Shqipëri kur linjat e telefonisë fikse, nuk ishin një komoditet i prekshëm nga të gjithë. Në sajë të përpjekjeve të vazhdueshme, kompania arriti të pajiste pjesën më të madhe të popullsisë me shërbime të një cilësie të pakrahasueshme. Sot, me më shumë se një milion abonentë, AMC përmbush nevojat për komunikim të të gjithë vendit. Si pjesë integrale e ekonomisë së vendit, AMC është e vetëdijshme për rolin e saj si një forcë drejtuese për zhvillimin dhe prosperitetin e shoqërisë shqiptare.

AMC është e përkushtuar të zbatojë të gjitha aspektet e Përgjegjshmërisë Sociale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, si dhe në kontaktet që ka me të gjitha palët (punonjësit, aksionerët, klientët, shoqërinë në përgjithësi dhe mjedisin). Duke iu përmbajtur standardeve strikte të etikës dhe transparencës, AMC përpiqet të garantojë një sukses të vazhdueshëm dhe në të njëjtën kohë të mbetet një pjesë integrale e komunitetit shqiptar.

AMC e ka vendosur shoqërinë, në të cilën operon, në qendër të aktiviteteve të korporatës. Kështu, AMC mbetet e përkushtuar për t'u shërbyer nevojave të kësaj shoqërie dhe për të ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së jetës brenda komunitetit. Programi i Përgjegjshmërisë Sociale në AMC është më shumë sesa një nismë afatshkurtër. Ai është një qëllim në vetvete, një mbështetje dhe një këndvështrim etik mbi aktivitetin e kompanisë. AMC e ka adoptuar plotësisht këtë program, e ka bërë atë pjesë të ADN-së së kompanisë, një tipar dallues të një kompanie konkurrense në tregun botëror. Përgjegjshmëria Sociale është një premtim për klientët, punonjësit dhe për komunitetin në tërësi. Ne jemi të ndërgjegjshëm se, për të pasur një biznes të suksesshëm, është e domosdoshme të kontribuojmë në komunitetin ku jetojmë, punojmë dhe shërbejmë.

#### Në lidhje me burimet njerëzore

Punonjësit e AMC-së janë çelësi i suksesit të kompanisë.

### Company Strategy

#### Corporate Social Responsibility Principles

AMC entered Albania when fixed line telephones while a necessity were a scarce commodity. Through continuous efforts the company was able to provide communication services for most citizens of Albania with unparalleled quality and all with a touch of a button. Today with slightly more than one million subscribers, AMC fulfills the communication needs of a nation. Operating in a developing economy, AMC acknowledges and embraces the role that it can play as a driving force for the progress and prosperity of the Albanian society.

AMC is committed to implement all aspects of Corporate Social Responsibility in all the business that it conducts and all contacts that it has with the stakeholders (employees, shareholders, customers, suppliers, society in general and the environment). Through strict ethical standards and transparency AMC strives to be a successful company while remaining an integral part of the Albanian community.

AMC places the society in which it operates at the heart of its corporate activities. As such, it is dedicated to serving its dynamic needs and to helping improve the quality of life within the community. Corporate Social Responsibility at AMC is more than just a short-term initiative. It is a commitment, a partnership, and an ethical lens on corporate development. AMC has fully adopted Social Responsibility, it has made it part of its company DNA, a permanent feature of a company competing in the global market. Corporate Social Responsibility is a pledge of loyalty to the AMC stakeholders; its customers, its employees, and the community as a whole. AMC understands that in order to succeed in business it is necessary to make a difference in the communities in which we live, work, and serve.

#### Regarding Human Resources:

AMC's employees are the key drivers behind the witnessed success of AMC. The company has made human resources a priority to ensure continuous growth of a healthy work



Burimet njerëzore mbeten përparësi për ne, në mënyrë që të sigurojmë një rritje të vazhdueshme të punonjësve dhe një mjedis pune të shëndetshëm. AMC respekton angazhimin dhe kultivon talentin e punonjësve, të cilët janë në shërbim të kompanisë dhe klientëve të saj. Kompania nxit potencialin e secilit për rritje personale dhe profesionale dhe përpiket të krijojë një mjedis të sigurt pune, me të drejta të barabarta për të gjithë punonjësit, pavarësisht nga gjinia, raca apo kombësia e tyre. Menaxhimi i burimeve njerëzore në AMC udhëhiqet nga parimet e Përgjegjshmërisë Sociale. Ndjenja e të qenit pjesë e një grupi, kultivimi i ideve të reja, mundësia e shërbimeve të avancuara dhe trajnimeve, të gjitha këto e bëjnë AMC-në një kompani të suksesshme, jo vetëm në vend, por edhe në rajon.

#### **Në lidhje me klientët**

AMC përpiket të ofrojë rrjetin më të mirë të mundshëm të telekomunikacionit për klientët e saj. Për më tepër, AMC është e ndjeshme ndaj nevojave të klientëve, duke ofruar shërbime të përshtatura sipas nevojës së tyre dhe duke e bërë telefoninë e lëvizshme të prekshme për të gjithë. AMC ekziston në sajë të klientëve, ndaj edhe këta të fundit mbeten në qendër të të gjithë veprimtarisë së saj. Politika e çmimeve konkurruese dhe shërbimet praktike që ofrohen, bëjnë që AMC të veçohet nga konkurrentët në disa drejtime. Cilësia, vlerat dhe performanca e shkëlqyer në shërbimet ndaj klientëve mbeten parime të qëndrueshme për AMC-në.

#### **Në lidhje me shoqërinë**

Kompania bën përpjekje për të qenë sa më aktive në shoqërinë shqiptare dhe beson se ndryshimet që ndodhin në shoqëri janë më të qëndrueshme. Kompania promovon në mënyrë aktive vlerat e një shoqërie demokratike dhe përpiket të krijojë mundësi për zhvillim për të gjitha shtresat e shoqërisë. Si pjesë e pandarë e shoqërisë shqiptare në këto vite ndryshimesh, AMC ka luajtur një rol dinamik si mbështetëse e

force and work environment, one which AMC prides itself on. AMC respects the commitment and cultivates the talent of employees who serve the company and its customers. AMC encourages each individual's potential for personal and professional growth and strives to create a safe working environment with equal rights for all employees, regardless of gender, race, or ethnicity. Principles of Social Responsibility guide human resource management at AMC. An environment of team spirit, the cultivation of new ideas, and availability of advanced services and training, makes AMC a success story in the corporate environment not only within the country, but across the region.

#### **Regarding Customers:**

AMC strives to provide its customers with the best telecommunications network possible. Moreover, AMC is sensitive to the needs of our customers, adjusting services as necessary and making mobile communication accessible and affordable to all. AMC exists because of its customers and therefore the company adopts a customer-centric approach. The firm's competitive pricing policy and its advanced, user-friendly and comprehensible services set AMC apart from competition within the country. Quality, value and excellence in services to customers are AMC's uncompromising principles.

#### **Regarding Society:**

The company makes a conscious effort to become an active player in Albanian society. AMC believes that changes that happen within are the most effective and enduring ones. The company actively promotes democratic values in society and seeks to create opportunities for advancement in all levels of society. As part of Albanian society in these years of dramatic societal change, AMC has played a dynamic role as a supporter of development and of values for a free and open society, one with opportunities and equality for all.

zhvillimit dhe vlerave për një shoqëri të lirë dhe të hapur, një shoqëri me mundësi dhe barazi për të gjithë.

#### **Në lidhje me furnitorët**

Bazuar në praktikën më të fundit për menaxhimin e lidhjeve me partnerë të ndryshëm, AMC ndjek një strategji të shqyrtuar mirë për përzgjedhjen e këtyre të fundit, ku transparencja, besueshmëria, dhe cilësia mbeten kritere bazë. E ndërgjegjshme se performanca dhe imazhi ynë në komunitet mund të ndikohen nga aktiviteti i partnerëve tanë, AMC ka përvetësuar dhe zbatuar parimet e Përgjegjshmërisë Sociale në të gjitha hallkat e zinxhirit të marrëdhënieve tregtare me partnerët.

#### **Në lidhje me investitorët**

AMC duke u udhëhequr nga parime të qëndrueshme dhe strikte në drejtimin administrativ, ka përvetësuar praktika efektive të auditimit të brendshëm. Kompania i jep një rëndësi të veçantë drejtimit sa më efektiv dhe ka krijuar një sërë rregullash të brendshme, parimesh dhe mekanizmash monitorimi, në mënyrë që menaxhimi të realizohet në përputhje me interesat e aksionerëve të saj. Nëpërmjet vënies në jetë të këtyre parimeve, kompania ka qëllim krijimin e besimit të ndërsjellë ndërmjet aksionerëve dhe stafit menaxhues. Procedurat e mbikëqyrjes dhe kontrollit të aktiviteteve të kompanisë, duke qenë vazhdimisht në funksion të interesave të aksionerëve, sigurojnë transparencë për investitorët.

#### **Në lidhje me mjedisin**

Si çdo biznes i përgjegjshëm, AMC përpiket të ushtrojë aktivitetin e saj në një mënyrë sa më pak të dëmshme për mjedisin, duke minimizuar çdo efekt që veprimtaria e saj mund të ketë në të. Kompania po përpiket të zhvillojë një Sistem për Menaxhimin Mjedisor, ndërkohë që ndërgjegjëson klientët dhe punonjësit e saj për një sjellje sa më të përgjegjshme në raport me ekosistemin rrethues. Zhvillimi i veprimtarisë së saj në një mjedis të shëndetshëm është pjesë e planit të AMC-së për të ardhmen.

#### **Regarding Suppliers:**

With quality, transparency, and reliability as key criteria, AMC implements a uniform supplier selection policy based on the latest supplier management practices. Acknowledging that our social performance may be affected by supplier activities, AMC has developed and applied Social Responsibility practices in the supply chain management process.

#### **Regarding Investors:**

AMC applies sound and clear Corporate Governance principles and effective internal audit practices. The company places great emphasis on proper Corporate Governance and has established a set of internal regulations, principles as well as monitoring and control mechanisms in order to ensure that the company is managed in accordance with the interests of its stakeholders, that is, all those who have a legitimate interest in the activities of the company. Through the application of these corporate governance principles, the company aims to build trust between shareholders and management and to divide powers and responsibilities between shareholders and management as effectively as possible. The procedures for oversight and control of the company's activities provide the investors with transparency and protect the interests of the shareholders.

#### **Regarding the Environment:**

AMC, just as any other responsible company, strives to conduct business in an environmentally-friendly way, minimizing any effects that its activities may have on the environment. The company seeks to develop an Environmental Management System, while increasing awareness among its customers and employees for responsible behavior towards our eco-system. Fully operating in a healthy environment is part of AMC's visionary plan for the future.

## 3 Aktorët Kryesorë: Punonjësit Tanë

### The Key-Players: Our Employees

#### Punonjësit tanë

##### Çelësi i suksesit

Punonjësit janë çelësi i suksesit të AMC-së. Në pozitat e një punëdhënësi të standardeve evropiane, AMC ofron ambient pune të sigurt dhe të shëndetshëm, rregullore e politika të brendshme të qarta dhe jo-diskriminuese, liri mendimi dhe shprehjeje, si dhe dialog të hapur ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve. AMC ka sjellë një mendësi të re në menaxhimin e politikave të burimeve njerëzore dhe krijimin e vendeve të punës. Kompania kujdeset jo vetëm për performancën personale të punonjësve, por gjithashtu edhe për zhvillimin e tyre personal dhe profesional. AMC nxit risitë dhe talentin dhe i transformon ato në produktivitet dhe efikasitet. Kompania ndjek praktika të ndryshme, të cilat përfshijnë sistemet e zhvillimit të aftësive profesionale, paketa shpërblimi tërheqëse, aktivitete sociale për krijimin e një mjedisi optimal pune, etj. Çdo punonjës i AMC-së përfaqëson njëkohësisht edhe vlerat e qëllimet e kompanisë, duke iu përmbajtur parimeve të Përgjegjshmërisë Sociale dhe duke pasqyruar rritjen e shëndetshme të kompanisë në vite. Ruajtja e standardeve të larta dhe e marrëdhënieve të shkëlqyera me klientët dhe aksionerët është bërë e mundur vetëm përmes punës së shkëlqyer të punonjësve tanë.

##### Të dhëna lidhur me punonjësit

Numri i punonjësve të AMC-së është rritur në vite, duke reflektuar kështu edhe rritjen e përgjithshme të kompanisë në Shqipëri. Në vitin 2006, numri i të punësuarve në AMC arriti shifrën 532 punonjës, nga të cilët, 54.6% janë gra dhe 45.4% janë burra, me një moshë mesatare 31 vjeç. 79.9% e punonjësve kanë diplomë universitare, dhe pasuniversitare, 7.8% kanë diplomë shkolle të mesme teknike dhe 0.9 % kanë mbaruar arsimin e detyrueshëm (këta të fundit janë kryesisht korrierë).

AMC mbledh rreth vetes më të aftët dhe më të mirët, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë personal. Kompania ofron mundësi karriere për të sapodiplomuarit,

#### Our Employees

##### The drivers of success

Employees are the heart of AMC's success. As a world-class quality employer AMC makes sure to provide a safe and healthy workplace, fair and clear policies and procedures, freedom of opinion and expression for all, and an open dialogue among all levels of employees. AMC has brought a new mentality to job creation and human resources policies in the country. The company is concerned not only with the employees performance, but with their personal and professional development as well. AMC cultivates innovation and talent and transforms it into productivity and excellence. The company implements several practices that include, professional skills development systems, appealing remuneration packages, activities to create an optimum and sophisticated work environment etc. Each and every one of AMC's employees represents the values and goals of the company, clearly adopting the Social Responsibility principles and mirroring the healthy growth of the company over the years. It is only through the exceptional work of these valuable players that AMC is capable of holding such high corporate standards and maintaining great relationships with its customers and all of its stakeholders.

##### Statistical Data

AMC's work force has grown over the years, reflecting the overall growth of the company in Albania. In 2006 the number of employees reached 532. Of all the people that work for the company 54.6% are women and 45.4% men with an average age of 31 years. 79.9% of the employees hold a university degree or higher, 7.8% have technical high school degree, 11.4% have a high school degree and 0.9% have compulsory education degree (the latter are mostly couriers).

AMC attracts the best and the brightest, professionally as well as personally. The company offers advancement opportunities for young graduates as well as great benefits for more experienced and qualified employees.



si dhe përfitime të mëdha për punonjësit më me përvojë dhe më të kualifikuar. Kushtet e shkëlqyera të punës i bëjnë punonjësit e AMC-së një aset, jo vetëm për kompaninë, por dhe për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi.

AMC është në kërkim të vazhdueshëm të mënyrave për ta bërë vendin e punës sa më të shëndetshëm, të këndshëm dhe produktiv për punonjësit e saj. Jo shumë kompani në Shqipëri mund të krijojnë avantazhet që ofron AMC. Duke besuar se janë pikërisht punonjësit e saj, ata që e mbajnë në duar suksesin e kompanisë, AMC do të vazhdojë rrugën drejt rritjes së vazhdueshme të mirëqenies së tyre.

#### **Përfitimet kryesore.**

AMC ofron paketa shpërblyese konkurruese dhe përfitime të tjera, si:

- Marrëveshje të veçanta me kompanitë e tjera për tarifa të reduktuara për punonjësit e AMC-së.
- Programe tarifore për të gjithë punonjësit, me çmime veçanërisht të lira, plus një sasi të caktuar kohe bisede falas dhe një numër me po të njëjtin program tarifor për të afërmit e tyre.
- Dhurata dhe shpërblime të veçanta në raste festash.
- Politika elastike për lejet nga puna dhe kujdes për nevojat e veçanta.
- Mbulimi i kostove të kujdesit shëndetësor.
- Organizimi i aktiviteteve sportive dhe të tjera, me qëllim përmirësimin e jetës profesionale dhe personale të punonjësve.

#### **Krijimi i një mjedisi barazie për të gjithë**

AMC krenohet me përkushtimin e saj për barazi gjinore dhe mundësi të barabarta për të gjithë, pavarësisht prejardhjes apo racës. Kompania numëron 56.4 % punonjëse femra dhe përdor një metodë punësimi gjithëpërfshirëse. Rekrutimi, veçanërisht ai i grave,

The excellent working conditions make AMC employees an asset not only to the company but to the developing economy and society as a whole.

AMC leads the way with incentives to make the workplace more productive, healthy, and enjoyable for its employees. Very few companies in Albania can match the benefits that AMC has to offer. The company is always on the look-out to add any benefits that may make employees more comfortable, more satisfied and motivated and consequently more efficient. AMC believes that its employees hold the success of the company in their hands and therefore the company is willing to go out of its way to ensure the well-being of its team.

#### **Key Benefits:**

AMC offers competitive remuneration packages and voluntary benefits, such as:

- Special agreements with other companies for special discounts for its employees in terms of products and services.
- Corporate mobile phones for all employees with special inexpensive programs and a bonus corporate phone of the same program for their dear ones.
- Gifts and special rewards on festive occasions.
- Flexible leave policy, attentive to special needs.
- Covering costs of health care.
- Organization of sports activities and other events with an aim to balance employees' professional and personal life

#### **Creating an Environment of Equality for All**

AMC prides itself on its commitment to gender parity and equal opportunities for all individuals regardless of where they come from or their ethnicity. The company holds a 56.4% record of female employees and the recruiting process has gathered people from all over the country to work together

under the label of the leading mobile operator in Albania. AMC has consciously employed people from all different backgrounds and in particular women in order to close the gender gap that may exist in the work force. AMC has made great progress in creating an environment of equality and diversity in the workplace whose success speaks for it.

#### **Sigurimi i kushteve të shkëlqyera të punës**

Një ndër përparësitë e AMC-së është sigurimi i një mjedisi të shkëlqyer pune për të ndihmuar punonjësit të shfaqin dhe të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre. AMC mbetet e përkushtuar t'u ofrojë më të mirën punonjësve të saj. Teknologji e fjalës së fundit, ushqim cilësor dhe me çmim të arsyeshëm, transport i siguruar dhe një mjedis pozitiv, janë vetëm disa nga mënyrat se si AMC shpreh vlerësimin për punonjësit e saj. AMC ka vendosur standarde të larta komunikimi brenda kompanisë dhe nuk toleron sjellje që devijojnë nga vlerat dhe parimet e saj. Respekti, mirësjellja dhe profesionalizmi karakterizojnë vendin e punës në AMC.

#### **Motivimi i punonjësve**

Çdo vit eprorët kryejnë vlerësime të arritjeve individuale për vartësit e tyre. Secili punonjës vlerësohet në bazë të dy kritereve që janë themelore për suksesin e kompanisë: aftësia për të punuar në grup dhe për t'u përshtatur nevojave të kompanisë. Nëpërmjet kësaj procedure, AMC thekson se sa e rëndësishme është që kompania të ketë një vizion të përbashkët, çka e vërteton puna në grup dhe përpjekjet e përbashkëta për të pasur sukses. Shpërblimet financiare janë një pjesë e pandarë e politikave të motivimit të punonjësve të AMC-së. "Punonjësi i muajit" dhe "Punonjësi i vitit", janë çmimet që u japin punonjësve për t'i motivuar ata. Për më tepër, mbrëmje, festa dhe aktivitete të tjera për punonjësit, janë organizuar periodikisht si pjesë e rëndësishme e procesit të forcimit të lidhjeve mes tyre.

#### **Sigurimi i mundësive për edukim dhe zhvillim**

AMC e konsideron edukimin e vazhdueshëm dhe ngritjen profesionale si një kërkesë kyçe për të ardhmen dinamike të kompanisë. Në këtë përpjekje kompania ofron rregullisht

er under the label of the leading mobile operator in Albania. AMC has consciously employed people from all different backgrounds and in particular women in order to close the gender gap that may exist in the work force. AMC has made great progress in creating an environment of equality and diversity in the workplace whose success speaks for it.

#### **Providing Excellent Working Conditions**

A key priority for AMC is to provide an excellent working environment that enables employees to perform to the best of their capabilities, benefiting their own as well as the company's development. AMC remains committed to provide the best for its employees. State of the art technology, qualitative dining services at low costs, facilitated transportation, and a positive environment are a few ways that AMC expresses its appreciation to its devoted employees. AMC enforces high standards of communication within its company and does not tolerate behavior that deviates from the general values and principles of the company. Respect, compassion, and professionalism characterize the excellent workplace at AMC.

#### **Employee Incentives**

Once a year each individual performance appraisals are conducted with AMC employees and evaluated by their respective superiors. Each employee is graded based on two criteria crucial to the company's success: the ability to work in groups and the ability to adapt to the needs of the company. Through this procedure AMC seeks to emphasize the importance of having a common vision for the company, enhanced by teamwork and collaborative efforts to succeed. Financial rewards are an integral part of AMC's employee-motivation policies. "Employee of the Month" and "Employee of the Year" are prizes which are awarded to provide an incentive for employees to achieve their best. Furthermore, employee parties, festivities, and other group activities are organized periodically as an important part of the socialization and trust-building process among them.



programe trajnimi të specializuara, brenda dhe jashtë vendit. Përveç seminareve të brendshme të trajnimit, AMC kryen gjithashtu seminare trajnimi të specializuara në teknologji dhe menaxhim, në bashkëpunim me organizatat e akredituara, nëpërmjet metodave të avancuara të edukimit me kompani vendase dhe të huaja. Vetëm në vitin 2006 punonjësit kanë marrë pjesë në rreth 580 orë trajnimi teknik dhe 158 orë trajnimi në menaxhim dhe ekspertizë profesionale. Një numër i madh kompanish i kanë pajisur punonjësit e AMC-së, gjatë seminareve dhe trajnimeve, me njohuritë e fundit të zhvillimit teknologjik, si dhe me aftësi biznesi dhe zgjidhje dinamike menaxhimi.

#### **Krijimi i një identiteti dhe kulture të përbashkët**

Duke besuar në natyrën humane të punonjësve të saj, AMC ka qenë dëshmitare e shumë nismave të punonjësve të saj, në kuadër të Përgjegjshmërisë Sociale të kompanisë. Fushata për dhurimin e gjakut, organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Kryqin e Kuq Shqiptar, ka përfshirë shumë punonjës të AMC-së. Një tjetër aktivitet i iniciuar dhe organizuar nga punonjësit e AMC-së ishte fushata në ditën ndërkombëtare kundër të SIDA-s. Shuma e mbledhur shkoi në mbështetje të 11 fëmijëve shqiptarë të infektuar me HIV. Një tjetër fushatë në mbështetje të fëmijëve të fshatit SOS i bëri punonjësit të blejnë më shumë se 500 kartolina të krijuara nga vetë fëmijët. Të gjitha këto nisma, jo vetëm kontribuojnë shumë në shoqërinë shqiptare, por krijojnë një ndjesi identiteti dhe kulture të përbashkët mes punonjësve të AMC-së, duke reflektuar qartë prioritetet dhe parimet e kompanisë për mënyrën e të bërit biznes.

"Të punosh për AMC-në është një përvojë e rëndësishme si në vendin e punës dhe jashtë tij, kjo falë mjedisit profesional që të rrethon dhe përfitimeve të shumta për mua dhe familjen time."

-Matilda Xh. Departamenti i Prokurimeve

#### **Providing Education and Development Opportunities**

AMC considers continuous education and professional improvement a key requirement for the dynamic future of the company. In this effort, the company regularly offers specialized training programs in and out of the country. Along with the internal training seminars, AMC also implements specialized training seminars on technology, management, in cooperation with accredited organizations and through advanced learning methods with national and foreign companies. In year 2006 alone AMC employees were involved in about 580 hours of technical training and 158 hours of management and skill training. A dozen companies led AMC employees through workshops and training sessions equipping them with the latest knowledge of technological development as well as with business skills and dynamic management solutions.

#### **Creating a Common Culture and Identity**

Firmly believing in the good-willed nature of its employees, AMC has witnessed many employee initiatives in the framework of Corporate Citizenship. A blood donation campaign conducted in close collaboration with the Albanian Red Cross turned many of AMC employees into donors. Another peak activity solely initiated and carried out by AMC employees was a fundraising campaign in support of 11 Albanian children infected with HIV. Another campaign in support of the SOS Children Village had employees buy more than 500 postcards designed by the children themselves. All these initiatives not only contribute greatly to Albanian society but create a sense of common identity and culture among the employees of AMC, clearly reflecting the company's priorities and principles in conducting its business.

"Working for AMC has been a remarkable experience both inside and outside the work place, respectively due to the professional surrounding environment and the multitude of employee benefits for me and my family."

- Matilda Xh. Procurement Department

"Të punosh në AMC është më shumë se një punë, është një mundësi për t'u rritur e maturuar, si profesionalisht dhe personalisht"

-Ada K. Departamenti i Mirëmbajtjes dhe Veprimit

"Ajo çfarë më pëlqen më shumë tek AMC, në këndvështrimin tim si punonjës, nuk është paga që marr apo puna që bëj, as ngritjet në detyrë që mund të përfitoj, nëse punoj mirë. Unë i konsideroj këto pjesë të punës sime. Janë njerëzit, me të cilët punoj, respekti që fitoj dhe, mbi të gjitha, është ndjenja e të punuarit për një kompani serioze, siç është AMC."

- Aldi V. Departamenti i Marketingut

"Ndryshe nga shumica e mjediseve të punës në Shqipëri, në AMC njerëzit inkurajohen të punojnë mirë dhe shumë, dhe jo thjesht për një përgëzim, por nëpërmjet mundësive për të ndërthurur një karrierë të qëndrueshme."

- Brikena R. Departamenti i Financës

"Working at AMC is more than a job, it is an opportunity to grow and mature, both professionally and personally."

- Ada K. Operation and Maintenance Department

"What I like most about AMC in my view as an employee is not the salary I get or the work I do, or the promotions I may get if I work well; I consider them part of my job. It is the people I work with, the respect I get, and at the end of the day, it is the feeling of working for a serious corporation such as AMC."

- Aldi V. Marketing Department

"Unlike most Albanian work environments, at AMC one is encouraged to work well and hard, and not through a tap on the back, but through a solid career building opportunity."

- Brikena R. Finance Department

## 4 Telefoni Celulare e një Cilësie Ndërkombëtare World-Class Mobile Telephony Operations

### Zhvillime të nivelit botëror në telefoninë celulare

#### Praktika të përgjegjshme biznesi që çojnë në suksesin e një kompanie

AMC beson se veprimet e brendshme, të sakta dhe transparente, janë një domosdoshmëri për rritjen dhe zhvillimin e një kompanie. Për më tepër, vetëm nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të vazhdueshëm të praktikave të menaxhimit, kompania mund të mbështesë më mirë interesat e të gjitha palëve, qofshin ata klientë, aksionerë apo të tjerë, të cilët kanë interes legjitim në aktivitetet e kompanisë.

AMC vepron në përputhje me parimet e menaxhimit të korporatës, që sigurojnë procesin e përfshirjes dhe transparencës në të gjitha aktivitetet e kompanisë për investitorët, si dhe mbrojtjen e interesit legjitim të aksionerëve. Kontrollat të vazhdueshme financiare organizohen për të vlerësuar dhe përmirësuar mekanizmat e kontrollit, që lidhen me aktivitetet e kompanisë.

Si pjesëtare e Grupit COSMOTE, AMC, që nga krijimi i saj, ka pasur si parim bazë ofrimin e shërbimeve duke u kujdesur gjithmonë për mjedisin rrethues. Një seri konsultimesh, takimesh dhe korrespondencash me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave kanë sjellë mirëkuptimin dhe ndihmën konstruktive që ka karakterizuar bashkëpunimin ndërmjet këtyre dy institucioneve. Një bashkëpunim i tillë gjithashtu ka hapur rrugën për përmirësimin e legjislacionit në mbrojtje të mjedisit. Nën këtë strukturë, kompania mbetet e përkushtuar:

- Për të siguruar ndihmë për çdo lloj ekspertize teknike të nevojshme, për fuqizimin e legjislacionit në lidhje e mjedisin.
- Në komunikimin me autoritetet vendore për të respektuar gjithmonë detyrimet e saj ligjore ndaj shoqërisë.
- Në përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin publik nëpërmjet takimeve, sesioneve këshilluese dhe botimeve.
- Për të mbështetur aktivitetet, që janë pjesë e zhvillimit të proceseve të tilla.

### World-Class Mobile Telephony Operations

#### Responsible Business Practices make for a Successful Company

It is AMC's belief that proper and transparent internal operations are a requirement for a company to grow and develop. Moreover, only through persistent monitoring and control of management practices can the company best uphold the interests of all parties involved, be they customers, shareholders or others who have a legitimate interest in the activities of the firm.

AMC abides by Corporate Governance principles which ensure the process of oversight and provide transparency in all company activities for investors as well as protecting the legitimate interest of shareholders. Regular audits are conducted to assess and improve control mechanisms related to the corporation's activities.

As a member of the COSMOTE GROUP, the leading philosophy in all AMC developments, from its creation on, rests in providing services through a constant concern for the surrounding environment. A series of consultations, meetings, and correspondences with the Ministry of Environment, Forest and Water Administration have achieved the understanding, guidance, and constructive help that have characterized the cooperation between the two bodies. Such interaction has also paved the way for the improvement of the legislation in protection of the environment. Under this framework, the company remains dedicated to:

- Provide assistance for any kind of technical expertise necessary for the empowerment of the current legislation in force on environmental matters.
- Communicate with the local authorities to always respect its lawful obligations to society.
- Attempt to raise public awareness through meetings, consultancy sessions, and publications.
- Provide support for activities which are part of the development of such process.



Ndërsa ofron shërbime cilësore në të gjithë vendin, për AMC-në është e domosdoshme të garantojë sigurinë dhe shëndetin e komunitetit, ku ajo vepron. Ky është faktor përcaktues për mënyrën se si ne kryejmë biznesin tonë. AMC, në biznesin e saj, vazhdon të jetë e përkushtuar në tri drejtime, duke baraspeshuar rritjen ekonomike me përkushtimin e vazhdueshëm ndaj mjedisit dhe shoqërisë.

Si pjesë e Grupit COSMOTE, në ndërtimin e rrjetit të saj kryesor, AMC përdor sistemin GSM të markës së njohur NOKIA, duke aplikuar teknologjinë e komunikimit DX200. Me qëllim që, jo vetëm të përshtatet me standardet evropiane të përhapjes së energjisë elektromagnetike, por dhe për të ruajtur reputacionin e liderit në treg në fushën e teknologjisë GSM, NOKIA është e përkushtuar në rritjen dhe përmirësimin e sistemeve të saj. Deri më sot, AMC ka realizuar zëvendësimin dhe përmirësimin e gjysmës së teknologjisë së rrjetit të saj, duke u hapur kështu rrugën zhvillimeve më të fundit në këtë fushë. Ky zëvendësim ishte një hap i madh përpara, i cili gjithashtu sjell një ulje të ndjeshme të përhapjes së energjisë elektromagnetike rreth stacioneve bazë. Deri në fund të vitit 2007 projekti i përmirësimit të rrjetit do të ketë përfunduar plotësisht.

Në mënyrë që AMC të ruajë rolin e saj si lider në komunikim, na është dashur të tregojmë kujdes edhe për dimensionin shoqëror të biznesit tonë. Telefonat celularë kryejnë një nga detyrat më të rëndësishme për njerëzimin, komunikimin, i cili i ndihmon qytetarët në rrethana të vështira, sic janë shërbimet emergjente. Duke pasur mundësinë e përdorimit të shërbimeve, pavarësisht vendndodhjes, krijon një ndjenjë sigurie tek abonentët. Në jo pak raste sinjalet e telefonisë celulare kanë ndihmuar në gjetjen dhe shpëtimin e individëve të gjendur në situata të vështira, duke minimizuar kështu edhe rrezikun në jetën e tyre. AMC ofron thirrje falas për shërbimet e urgjencës: 127 Urgjenca, 128 Policia, dhe 129 Zjarrfikësja. Ky është një shërbim që më parë nuk ekzistonte në vend, madje as nëpërmjet linjave fikse.

While, providing quality services anywhere in the country, it is imperative for AMC to guarantee the safety and health of the community within which it operates. This is a determining factor of the way we conduct our business. AMC remains committed to a triple bottom line approach to business, balancing economic growth with persistent dedication to the environment and society.

As part of the COSMOTE Group, AMC in building its core network, uses the GSM system of the well-known NOKIA brand using DX200 communication technology. In order to not only abide by the European standards on electromagnetic energy emission, but to also to maintain its reputation as a market leader in the area of GSM technologies, NOKIA is committed to continuous upgrading of its systems. To this date, AMC has executed the replacement and upgrade of half of its network technology, paving the way for the latest advancements in the field. This replacement was a major step forward resulting in a major decrease in the levels of EME emissions around the base stations. By the end of 2007 the upgrade project will be fully implemented.

In order for AMC to fully embrace the role as Albania's leader in mobile telephone communication, we've had to acknowledge the social dimension of our business. Mobile phones are used for one of the most important tasks of humanity, communication, which at times aids citizens in difficult circumstances such as emergency services. This creates a sense of security for customers owning a mobile phone, capable of reaching services no matter where they are. In many cases mobile signals have helped in locating and rescuing many individuals in difficult situations, minimizing the risk to their lives. AMC offers free calls to emergency services: 127 Emergency Room, 128 Police Station, and 129 the Fire Station. This is a service was not available before in the country, even with the fixed line service.

Duke qenë një kompani me standarde të larta etike dhe morale, AMC përpiqet t'u japë informacion të qartë e të saktë të gjithë abonentëve të saj, si dhe komunitetit. Komunikimi dhe informimi janë dy shtylla kryesore të strategjisë aktuale të kompanisë. E përmuajshmja "Flasim", botim i AMC-së, është një përpjekje për të rritur komunikimin ndërmjet kompanisë dhe abonentëve të saj. Gjithashtu, broshurat informative të shpërndara në të gjithë komunitetin paraqesin ofertat e AMC-së dhe mundësitë më të mira për klientët. Konferencat dhe deklaratat për shtyp janë vetëm një pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të krijuar një urë të përhershme komunikimi ndërmjet kompanisë dhe klientëve që përdorin produktet e saj. "Revista AMC", botimi i përmuajshëm, i cili lindi në fund të vitit 2006, shpjegon me hollësi produktet që ofron AMC dhe jep informacion të vlefshëm për ofertat e saj sezonale. Ky botim dëshmon edhe një herë përkushtimin e AMC-së ndaj abonentëve.

"068" është një tjetër shembull i premtimit që kompania ka bërë për të ruajtur lidhjet me pjesën më të rëndësishme të saj, abonentët. Ky botim nxjerr në pah anët më të mira të jetës në Shqipëri e në botë nëpërmjet një sërë rubrikash kulturore, artistike, sportive, teknologjike etj.

Përveç botimeve, AMC ofron një faqe interneti informative, ku klientët apo kushdo tjetër i interesuar mund të hyjë lehtësisht dhe të gjejë informacion të shpejtë. Ngjarjet dhe lajmet e AMC-së janë pasqyruar në faqen e internetit me shkrime e foto ilustruese. Klientët mund të shfrytëzojnë shërbimin e faturës elektronike, të konsultojnë tabelat e tarifave, hartën e mbulimit, manualët e aktivizimit apo përdorimit të shërbimeve.

Kujdesi për Abonentin është vetëm një telefonatë larg kujtdo që është i interesuar. Mbi 100 përfaqësues të Kujdesit për Abonentin, që u përgjigjen telefonatave në numrin pa pagesë 139 ose 144 gjatë çdo ore të ditës apo të natës, e bëjnë

As a company with high ethical and moral standards, AMC strives to make available clear and precise information to all customers and members of the community. Communication and information are the two major pillars of the company's current strategy. The monthly "Flasim" an AMC publication is an effort to increase the communication scope between the company and its customers. In addition informative leaflets distributed through out the community present AMC's offers and the best deals available to customers. Press conferences, press releases etc. are just part of an on-going effort to create a permanent bridge between our valued consumers using AMC products and our corporate base.

Just at the end of year 2006 a new and exciting concept took off, "AMC Magazine." This comprehensive monthly publication explains the products AMC offers in detail and provides helpful information for anyone interested in handsets, seasonal offers, and a whole lot more. This publication symbolizes AMC's world-class dedication to customer service and communications with mobile phone users.

"AMC 068" is another example of the pledge that the company has made to keep in touch with what matters... the customer base. This publication highlights the best of Albanian and International lifestyles and presents a variety of topics such as culture, arts, sports, technology etc.

Besides the hard copies of information disseminated by the company, AMC provides an exceptionally informative web-site where customers or anyone interested in mobile service can easily navigate and get quick and ready information. AMC news and events are also available on the website with lively pictures and colors. Customers can gain access to e-billing, tariff charts, coverage maps, activation manuals and any other service related issues.

Customer care is only one click or one free call away from

AMC-në një kompani të spikatur përse i përket ndjeshmërisë ndaj abonentit. Me Kujdesin e Abonentit mund të komunikohet edhe me e-mail.

Vizioni i AMC shkon përtej asaj çka ka arritur tashmë. Duke pasur si synim të ardhmen, AMC ndodhet në ndryshim të vazhdueshëm për t'iu përshtatur realitetit gjithnjë në zhvillim, si dhe nevojave përherë në rritje të shoqërisë. AMC mbetet e hapur ndaj komenteve, sugjerimeve, kritikave, apo opinioneve që mund të kenë abonentët ekzistues apo abonentët e mundshëm. Kompania e shikon këtë si një mundësi për t'u rritur e për të zgjeruar kanalet e komunikimit me ta.

AMC u siguron punonjësve të saj një gamë të gjerë informacioni në formën e broshurave, kodeve të etikës, manualeve etj. Ky informacion ndihmon në vendosjen e standardeve të punës, në nxitjen e praktikave të komunikimit të brendshëm e të jashtëm, të cilat nuk lënë vend për keqkuptim apo pikëpyetje në lidhje me rëndësinë e sjelljes profesionale në vendin e punës. Brenda kompanisë zbatohet një kod etike, i cili përfshihet në udhëzuesin që u jepet të gjithë punonjësve kur fillojnë punë. Ky udhëzues mund të merret edhe në mënyrë elektronike. Njëkohësisht, AMC ka vendosur në dispozicion të punonjësve edhe shumë manuale të tjerë proceduralë për sigurinë në vendin e punës, përdorimin e duhur të mjeteve të komunikimit të kompanisë etj. Departamenti i Burimeve Njerëzore u jep mundësi të gjithë punonjësve të shqyrtojnë dokumente të rëndësishme, që kanë të bëjnë me tema të tilla si legjislacioni shqiptar për punën, taksat dhe sigurimet shoqërore.

AMC ka vendosur rregulla të rrepta për të parandaluar keqpërdorimin e shërbimeve të saj jashtë kompanisë. Këtë politikë AMC ua dikton edhe palëve të treta. AMC është e ndjeshme ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e abonentëve të saj dhe me përmbajtjen e shërbimeve me vlerë të shtuar. AMC përdor mekanizma të ndryshme që ndalojnë përdorimin e disa fjalëve të caktuara.

anyone interested. Available like no one else in the country, 7 days a week, 365 days a year, AMC leads the way to excellence in responding to its valuable clients. More than a hundred customer care representatives respond to calls via free number 139 or 144. Also, customer service can respond via email at any time.

In addition, AMC is a company whose vision goes beyond what it has already achieved. The future is the territory AMC seeks to conquer and therefore the company is in a constant mode of change to adapt to the evolving reality as well as the ever demanding needs of the society. AMC is open to comments, suggestions, criticism or opinions that both existing and potential customers may have. The company sees this as an opportunity to grow and a chance to open the channels of communications with its valued customers.

AMC also provides a multitude of documents in form of handbooks, codes of ethics, manuals etc. to its employees. These set standards of work, encourage good internal and external communication practices which have no room for misunderstandings or questions regarding the importance of professional conduct at work-place. Internally a code of ethics is available and can be found in the employee handbook which is provided to all employees upon starting work. The handbook is also available electronically. Several other procedural manuals on safety and security at the work place, proper use of the company's means of communication etc. are also available to all. The Human Resources department ensures that all employees have access to important documents that deal with such topics as Albanian legislation on work, taxes and social security.

Externally, AMC has strict rules to prevent improper use of its services and we enforce this policy on third parties as well. AMC is sensitive to issues regarding the protection of its subscribers and in relation to the content of value added services provided by the company. AMC employs several mechanisms

Qëllimi është të filtrohet përmbajtja e papërshtatshme, në mënyrë që produkti të jetë sa më i sigurt.

Si një kompani e përgjegjshme, AMC ofron rregullisht broshura dhe fletëpalosje me informacion të vlefshëm për klientët në lidhje me mënyrën se si vepron sistemi i telefonisë celulare. Duke iu përgjigjur interesave që mund të kenë përdoruesit e telefonisë celulare, AMC shpërndan materiale informative që shpjegojnë aspektet teknike të shërbimeve të saj. Këto materiale synojnë të informojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve që mund të lindin në lidhje me ndikimin që mund të ketë telefonia celulare në shëndetin e njerëzve. Transparenca qëndron në thelb të politikave të AMC-së dhe përbën prioritet në qëllimet dhe aspiratat e saj.

Nëpërmjet urave të komunikimit, parimeve etike dhe përkushtimit ndaj cilësisë e shërbimit të shkëlqyer, AMC ka arritur suksese të reja në biznes. Arritjet e saj reflektohen në veprimet dinamike që kompania kryen vazhdimisht për t'iu përshtatur kërkesave të shoqërisë dhe abonentëve të saj. Vetëm nëpërmjet strategjive gjithnjë në ndryshim kompania mund të qëndrojë lider në treg dhe të bëhet ofruesi kryesues i shërbimit celular në Evropën Juglindore.

that can certain words from use on the service. These are intended to filter out any inappropriate content making for safer products.

As a responsible company, AMC provides brochures and leaflets on a regular basis with information that may concern customers regarding the way the mobile telephone system operates. Addressing concerns that mobile users may have, AMC distributes informative materials that explain the technical aspects of the company's services. These materials seek to inform and answer any questions users may have regarding the impact of mobile telephone technology could have on their health. Transparency is key to AMC's business conduct and represents a high priority in the company's goals and aspirations.

Through communication bridges, ethical principles, and commitment to quality and excellence in service, AMC has been able to rise to new heights of business success. The traces of its achievements are seen throughout the dynamic actions that the company continuously makes to adapt its management and leadership to the demands of the society and its customer base. Only through flexible ever-changing strategies is a company capable of capturing what is to come and become the leading mobile telephone service provider in South-eastern Europe.



## 5 Investimet Tona në Ekonominë e Vendit Our Investment in the Local Economy

### Investimi ynë në ekonominë e vendit

#### Sepse AMC kontribuon

Përdorimi i telefonisë celulare është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së fundit. Në nivel botëror ka rreth 1.5 miliardë përdorues të telefonisë celulare, ndërsa në vitin 2009, ky numër pritet të rritet në 2.4 miliardë. Vetëm në Evropë numërohen rreth 500 milionë përdorues celulari. Si kompania e parë që ka sjellë sinjalin e telekomunikacionit celular në Shqipëri, AMC ka dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e ekonomisë së vendit. AMC, si operatori lider në vend, kontribuon dukshëm në forcimin e sipërmarrjeve shqiptare dhe në krijimin e vendeve të punës.

Deri tani, AMC ka shpenzuar 85.6 milionë dollarë për marrjen e licencës dhe disa qindra milionë në investime dhe fonde sigurimesh. AMC ka kontribuar gjithashtu në krijimin e drejtpërdrejtë të 532 vendeve të punës, si dhe qindra të tjerëve në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Përveçse është një mjet thelbësor për komunikimin e përditshëm ndërpersonal, mbërritja e teknologjisë së telefonit celular ka kontribuar në rritjen e produktivitetit, konkurrencës në treg dhe në uljen e kostove të përgjithshme operative për bizneset e vogla. Për më tepër, prania e një kompanie të madhe dhe prestigjioze si AMC, shërben për të tërhequr investimet e huaja direkte në Shqipëri, çka sjell një zhvillim ekonomik.

Suksesi i AMC-së në Shqipëri është një tjetër tregues i zhvillimit ekonomik në vend. Sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik është çelësi i përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të hyrë në rrugën e duhur drejt Bashkimit Evropian. AMC, nëpërmjet partnerëve dhe rrjeteve rajonale, është e përgatitur të kontribuojë në këtë proces.

### Our Investment in the Local Economy

#### Because AMC contributes

Mobile telephone use has grown exponentially in the past decade. On a global level, there are approximately 1.5 billion mobile users, while by 2009 the number is expected to grow to 2.4 billion. Only in Europe, there are about 500 million mobile users. As the first company to bring the signal of mobile telecommunications to Albania, AMC has made a large contribution to the local developing economy. AMC as the leading operator in Albania, tangibly and significantly contributes to the enhancement of Albanian entrepreneurship and the creation of job opportunities.

To date the company has spent \$85.6 million for license acquisition and several hundred of millions in investments and insurance funds. AMC has also contributed to the creation of 532 direct employment opportunities and hundreds of indirect ones. Apart from being an essential tool for the daily interpersonal communication, the arrival of mobile telephone technology has significantly contributed to the growth of productivity, to the increase of competitiveness in the market and to the reduction of overall operationing costs for small businesses. In addition, the presence of a large and prestigious company such as AMC serves to attract foreign direct investments to Albania, which in the long run contributes to overall economic development.

The success of AMC in Albania is another indicator of the economic development in the country. Securing a stable economic environment is key to the efforts that the Albanian government is making to get on track to become part of the European Union. AMC, through its regional partnerships and networks, is prepared to contribute in this process for more regional collaboration.





## 6 Investimet Tona në Shoqëri dhe Mjedis Our Investment in the Society and the Environment

### Investimi ynë në shoqëri dhe mjedis

#### Pjesëmarrja si pjesë e programit të përgjegjshmërisë sociale

AMC është e vetëdijshme për rëndësinë që ka kontributi i saj në komunitetin ku vepron. AMC beson se ekzistenca e saj në shoqërinë bashkëkohore shqiptare përbën një marrëveshje dypalëshe të privilegjeve dhe të përgjegjësisë që pasojnë. Përballë një mundësie të tillë, AMC mbetet e përkushtuar ndaj përgjegjësisë së saj sociale, duke qenë e përfshirë drejtpërdrejt në aktivitete bamirësie dhe projekte të komunitetit. Me rritjen e pranisë së saj në vend, AMC është e përkushtuar të ndihmojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve shqiptarë dhe të ndryshojë diçka në jetën e atyre, të cilët në të kundërt nuk do kishin asnjë mundësi.

#### Kontribute (në €)

2001	2002	2003	2004	2005	2006
148,973	539,689	666,320	911,891	962,542	1,181,424

AMC nuk kontribuon vetëm financiarisht, por përpiqet të sjellë ndryshim nëpërmjet një zhvillimi kulturor të brendshëm. Duke filluar nga punonjësit e saj, AMC nxit dhe mbështet aktivitete, përmes të cilave ata ndihmojnë jetën e njerëzve nëpërmjet shërbimeve në komunitet, organizatave qytetare dhe praktikave të ngjashme. Duke u përfshirë në aktivitetet vendore, punonjësit e AMC-së janë shumë afër abonentëve të kompanisë dhe ndiejnë shqetësimin e tyre.

E ndërgjegjshme për nevojat e shumta të shoqërisë shqiptare, AMC e ka drejtuar vëmendjen në shumë projekte, duke u përfshirë në aktivitete artistike, sportive, si dhe në projekte të përkujdesjes sociale dhe shëndetësore. Përmes kontributit të saj në shoqërinë shqiptare, AMC ka ndikuar ndjeshëm në jetën sociale në vend.

### Our Investment in the Society and the Environment

#### Participating as Part of Genuine Corporate Social Responsibility

AMC fully acknowledges the importance of giving back to the communities in which it operates. AMC is a strong believer that its existence within the Albanian contemporary society represents a mutual recognition of the privileges as well the responsibilities that come with them. In the face of such opportunity AMC remains committed to respond to what it considers its social responsibility by being directly involved in charitable activities and community projects. As the company's presence in Albania has grown, AMC has positioned itself as a business dedicated to helping improve the lives of Albanian citizens and to making a difference for those people who otherwise would not have a chance.

#### Contributions (in €)

2001	2002	2003	2004	2005	2006
148,973	539,689	666,320	911,891	962,542	1,181,424

AMC does not only contribute financially but also seeks to make a difference through a cultural shift from within. Starting with its own employees, AMC encourages and fosters activities where its employees are able to touch the lives of others through community services, civic organizations and other life altering experiences. By getting involved in local initiatives, AMC employees are very close to the company's customers, capable of feeling the pulse of the consumers.

Considering the many needs that the Albanian society may have, AMC has directed its attention to multiple projects, engaging in arts and sports activities as well as in health and social care projects. By diversifying the contribution to the Albanian society, AMC has made a wide impact on the overall social life in the country.





### Kujdesi shëndetësor

Duke qenë se operon në një vend me ekonomi në zhvillim, AMC ka parë nevojën emergjente për të kontribuar për shëndetësinë në Shqipëri. Si një nga fushat më të neglizhuara gjatë periudhës së tranzicionit, kujdesi shëndetësor në Shqipëri paraqet sfida për qeverinë aktuale, si dhe për organizatat ndërkombëtare të shëndetit. Duke besuar në rëndësinë që ka kujdesi shëndetësor në ekonominë e një demokracie në konsolidim si Shqipëria, AMC ka ndjekur një strategji të mirëpërcaktuar në fushën e kujdesit shëndetësor.

Në vitin 2006, ndihma e AMC-së në sektorin shëndetësor shqiptar ka qenë shumëdimensionale. Në partneritet me autoritetet qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare, AMC e ka ndihmuar sektorin e shëndetësisë me:

- Informacion
- Ndërtim
- Risi
- Zhvillim

Në gjysmën e dytë të vitit 2006, AMC ka përfunduar projektin “Për rrjetin lokal kompjuterik në spitalin ‘Nënë Tereza’”. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti ishte implementimi i arkivit elektronik të të dhënave, përmirësimi i komunikimit të gjithanshëm dhe përpunimi i të dhënave të spitalit. Kapaciteti i pakufizuar i arkivit, kushte ruajtjeje maksimale, kërkim i shpejtë dhe i lehtë, shkëmbim i të dhënave mjekësore mes pavijoneve, mjete për analiza, kërkime dhe statistika më të lehta në të dhënat e ruajtura, janë disa nga përparësitë që sjell ky rrjet i kompjuterizuar.

Arkivi origjinal i Spitalit “Nënë Tereza” ruhej në kushte shumë të papërshtatshme dhe përpunimi i dosjeve në letër po bëhej përherë e më i vështirë. Procesi i dixhitalizimit ka dhënë tashmë rezultatet e para me rreth 60,000 dosje që ruhen në mënyrë elektronike. AMC ka dhënë kontributin e saj të vlefshëm për të mbështetur këtë projekt, i cili ka përmirësuar së tepërmi këtë aspekt të sistemit të kujdesit shëndetësor. Një tjetër aktivitet i rëndësishëm në fushën e kujdesit shëndetësor ka qenë kontributi në botimin e “Manualit për shëndetin e fëmijës”, një projekt i Ministrisë Shqiptare të Shëndetësisë, UNICEF-it dhe AMC-së. Manuali fokusohet te fëmijët deri në moshën 14 vjeç dhe synon të jetë manuali më i rëndësishëm për prindërit dhe mjekët në kujdesin ndaj fëmijëve.

### Health Care

Operating in a developing economy, AMC has recognized the emergent need for health care contributions in Albania. Being one of the fields mostly neglected during the transition time to democracy, health care in Albania presents challenges for the current government as well as for international health organizations. Firmly believing in the importance of health care for the economy of a consolidating democracy such as Albania, AMC has developed a well-determined strategy in the area of health care as highlighted by its Corporate Citizenship initiatives.

In 2006, AMC's participation in assisting the Albanian health sector has been multidimensional. In partnership with government authorities and international organizations, AMC has provided the Albanian health sector with:

- Information
- Construction
- Innovation
- Development

In the second half of year 2006, AMC finished the “Mother Teresa Hospital LAN (Local Area Network) Project”. The network's major goal was the implementation of electronic archiving of the data and improving the overall communication and data processing of the hospital. Unlimited archive capacity, state-of-the-art storing conditions, fast and handy search and retrieval methods, inter-pavilion exchange of medical records, and the means and the mechanics for easier analysis, research and statistics on the stored data, were only some of the advantages of such computerized network.

The original archive of the “Mother Teresa” Hospital was being preserved in very unfavorable conditions and the processing of hard copy files was becoming more difficult each day. The digitalization process has already yielded the first benefits, with approximately 60,000 files being electronically stored. AMC gave its essential contribution to support this project which has vastly improved this aspect of the health care system.

Another key activity in the field of health care was the contribution to the publication of the “Booklet of Child Health,” a project of the Albanian Ministry of Health, UNICEF and AMC. The booklet targets children aged 14 and under and aims to

Ai shërben si një regjistër, ku mbahen të dhënat e nevojshme për nënën dhe mjekun, duke siguruar informacion të saktë dhe të plotë për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Të dhënat e manualit tregojnë kontrollet që i janë bërë fëmijës, trajtimet mjekësore dhe karakteristikat gjatë periudhës së rritjes, informacion i vlefshëm për referencë mjekësore dhe prindërore.

Në vitin 2006, AMC ka vazhduar të japë mbështetjen e saj në fushën e shëndetit me Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi” në Tiranë, duke ndërtuar murin e tij rrethues. Kontributi i AMC-së ka bërë të mundur që mjekët të punojnë dhe të kurojnë pacientët në kushte më të sigurta dhe më të përshtatshme.

AMC beson se shoqëritë e shëndetshme janë kusht për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe sociale. Prandaj kompania mbetet e përkushtuar të kontribuojë në çdo mënyrë të mundshme për përmirësimin e sektorit shëndetësor në Shqipëri.

### Zamir MUÇA

Sekretar i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq Shqiptar - Secretary General of Red Cross Albania

“Kryqi i Kuq Shqiptar është një organizatë humanitare me bazë vullnetare, pjesë e Kryqit të Kuq Botëror dhe e Lëvizjes së Gjysmë-Hënës së Kuqe. Në punën e tij, Kryqi i Kuq Shqiptar udhëhiqet nga paanshmëria, humanizmi, objektiviteti, pavarësia, vullnetarizmi, uniteti dhe universaliteti, që janë edhe vlerat bazë të Kryqit të Kuq Botëror dhe Lëvizjes së Gjysmë-Hënës së Kuqe. AMC dhe Kryqi i Kuq Shqiptar kanë pasur një komunikim pozitiv dhe të frytshëm në fushën e kontributit social. Të udhëhequr nga interesi ynë për të ndihmuar njerëzit në nevojë, ne e kemi ndërthurur punën tonë në disa projekte. Ndër të përmendim fushatën me SMS për mbledhjen e fondeve në Ditën Ndërkombëtare të Urisë, ku shumat e mbledhura shkuan në ndihmë të azileve në të gjithë vendin, si dhe ditën e dhurimit të gjakut, ku punonjësit e AMC-së u bënë dhurues të drejtpërdrejtë. Ne jemi të kënaqur me këtë bashkëpunim, pasi kërkon punë nën një emërues të përbashkët, që është mirëqenia sociale. Në të ardhmen, mbetemi me dëshirën për të bashkuar forcat me AMC-në, një kompani po aq besnike ndaj komunitetit në të cilin vepron.”

be the premier child care handbook for parents and medical practitioners. It serves as a hard-copy record-keeper for mothers and doctors, providing accurate and complete data on the growth and development of the child. The booklet records show child examinations, medical treatments, and child characteristics during the growth period, information useful for parental and medical reference alike.

In 2006 AMC continued its health sponsorships with the Lung Diseases University Hospital “Shefqet Ndroqi” in Tirana, building its external surrounding wall. AMC's contribution has enabled doctors to work, treat and cure patients under safer and more favorable conditions.

AMC is a strong believer that healthy societies are a precondition to sustainable economic and social growth. Therefore, the company remains dedicated to contributing in any way possible to better the health care sector in Albania.

The “Red Cross Albania is a volunteer-based humanitarian organization, part of the large world-wide Red Cross and Red Crescent Movement. In its work, the Red Cross is led by neutrality, humanism, objectivity, independence, volunteerism, unity, and universality, core values of the international Red Cross and Red Crescents Movement. AMC and the Albanian Red Cross have enjoyed a positive and fruitful cooperation in the area of social activism. Led by our interest in helping those in need, we have intertwined our work in several projects. The SMS fundraising campaign in the framework of the international hunger day, where the amounts raised went in support of asylums around the country, and the blood donation day, where the AMC employees became direct donors. We were pleased with this cooperation as it required work under a common denominator, which is social welfare. In the future, we remain willing to combine forces with a company as loyal to the community it operates in, as AMC is.”



### Mirëqenia Sociale

AMC, në ndjekje të një strategjie gjithëpërfshirëse të Përgjegjshmërisë Sociale, është mbështetëse e vazhdueshme e nismave të ndryshme, të cilat synojnë rritjen e mirëqenies dhe zhvillimit. Pjesëmarrja dhe partneriteti në projekte, nisma të institucioneve qeveritare apo OJF-ve të ndryshme kanë qenë çelësi i suksesit në këtë fushë. Gjithashtu, vëmendje të veçantë në programin tonë të Përgjegjshmërisë Sociale u kemi kushtuar edhe çështjeve, ndaj të cilave shoqëria e sotme shqiptare është veçanërisht e ndjeshme.

Duke e ditur se problemi i trafikimit të qenieve njerëzore mbetet një nga çështjet më të nxehta në rajon, AMC ka mbështetur plotësisht nisma të tilla si MTV Exit, një koncert i organizuar nga MTV në Vlorë, pjesë e një serie koncertesh të mbajtura nëpër Evropën Lindore, ku fenomeni i trafikimit njerëzor është më i theksuar. Gjithashtu, AMC ka mbështetur Turin Çiklistik kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, të organizuar nga Shoqata "The Doors", me pjesëmarrjen e skuadrave nga të gjitha vendet e Ballkanit.

Një tjetër nismë në këtë fushë ka qenë "Nisma Rajonale Anti-Trafik", ku morën pjesë vullnetarë nga Shqipëria, Kosova, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Bullgaria dhe Rumania. Nën moton "Të Bashkuar Kundër Trafikimit Njerëzor", kjo nismë synonte të sensibilizonte shoqërinë ndaj kësaj çështjeje.

Njerëzit në nevojë kanë qenë një tjetër shtresë e strukturës sociale që ka tërhequr vëmendjen e AMC-së. Në këtë kontekst, janë organizuar shumë aktivitete si fushata e ndërgjegjësimit gjatë "Javës Evropiane kundër Dhimbjes", dhe fushata për mbledhjen e fondeve me SMS, organizuar në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar në kuadër të "Ditës Botërore kundër Urisë". Nga fushata u mblodh një shumë e konsiderueshme, e cila ju dhuroi disa shtëpive të të moshuarve nëpër Shqipëri. Fëmijët në nevojë kanë qenë në qendër të shumë projekteve, për të cilat AMC ka dhënë mbështetjen e saj ekonomike në përpjekje për ta bërë sa më të lehtë integrimin social të këtyre fëmijëve.

### Social Welfare

AMC, in its pursuit of a comprehensive strategy of Corporate Citizenship has been a continuous supporter of initiatives promoting social cohesion and development. Participation and partnership in projects initiated by national and international NGOs and government institutions has been a key for success in this area. AMC's role in such projects has varied from being a sponsor, to an initiator or an implementer, depending on the activity at hand.

Issues such as anti-trafficking, with particular sensitivity to the Albanian community, have been a starting point for many of AMC's social activities in the framework of Corporate Social Responsibility program.

Intimately familiar with the problem of human trafficking issues in the region, AMC has supported initiatives such as MTV Exit, a concert organized by MTV in Vlorë, part of a series of concerts throughout Eastern Europe where the human-trafficking issue is most salient. In addition AMC generously supported the Cycling Tour Against Human Trafficking organized by The Doors Association, where one team from each of the Balkan countries participated.

Another initiative in this area has been the "Regional Anti-Trafficking Initiative" involving volunteers from Albania, Kosovo, FYROM, Bulgaria, and Romania. Under the motto "United Against Human Trafficking" this initiative raised awareness about the matter.

Disadvantaged groups have been another target of the social framework of the AMC initiatives. In this context, several activities have been launched, such as an awareness campaign during the "European Week Against Pain", and the SMS fundraising campaign, in cooperation with the Albanian Red Cross, in the framework of the "World Hunger Day". The campaign raised a significant amount of money which was donated to several homes for the elderly around the country.



Rikonstruksioni i përgjithshëm i çatisë së Jetimoreve të Shkodrës u bë i mundur në sajë të një donacioni të kompanisë. Si pjesë e aktiviteteve të fundvitit, tashmë për 3 vjet radhazi, AMC ka organizuar festa të ndryshme, ku kanë marrë pjesë fëmijët e jetimoreve, fëmijët e policëve të vrarë në krye të detit, të fshatit SOS dhe nxënësit më të mirë të Tiranës. Në festën e Vitit të Ri 2006, Presidenti i Republikës, Z. Alfred Moisiu, së bashku me disa anëtarë të qeverisë, u bënë pjesë e këtij aktiviteti. AMC organizoi koncerte festive, ku fëmijëve iu shpërndanë dhuratat të shumta.

Më 1 dhjetor 2006, AMC u bashkua me institucionet, organizatat dhe partnerët të tjerë në luftën kundër SIDA-s, ose siç e ka quajtur ish-Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan “sfida më e madhe e brezit tonë”. Punonjësit e kompanisë vunë fjalën e kuqe në përkujtim të Ditës Botërore kundër SIDA-s, si dhe dhanë kontributin e tyre financiar në zyrat dhe dyqanet e AMC-së. Shuma e mbledhur u vu në ndihmë të fëmijëve shqiptarë të infektuar me HIV.

Më 23-25 nëntor 2006, zyrtarë nga Nisma e Evropës Qendrore (CEI), të krijuar 17 vjet më parë për të forcuar lidhjet ndërmjet rajonit dhe Bashkimit Evropian, si dhe përfaqësues të ndryshëm të institucioneve ndërkombëtare u mbledhën në Tiranë. Shqipëria mbante presidencën e radhës së kësaj organizate. Samiti vinte pas një forumi ekonomik, ku merrnin pjesë rreth 900 drejtues biznesi, të cilët diskutuan mundësitë për reforma dhe investime, për mënyrat e stimulimit të biznesit, konkurrencës dhe sipërmarrjes në Evropën Qendrore dhe Lindore. Forumi, së bashku me një Tavolinë të Rrumbullakët të Kryeministrit dhe Ministrave të Ekonomisë së vendeve pjesëmarrëse si dhe samiti përfundimtar ishin përbërësit kryesorë të aktivitetit. E vetdijshme për rëndësinë e nismave të këtij lloji, edhe një herë, AMC u bë mbështetëse e rëndësishme e mbajtjes së forumit të CEI-t.

Në dhjetor të vitit 2006, me ndihmën e NATO-s dhe AMC-së, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim botoi numrin e parë të revistës për “Çështje të Sigurisë”.

Disadvantaged children in need have been at the heart of many initiatives that AMC has provided economic support for in an effort for social integration. A general reconstruction of the roof top of the Shkodra orphanage was made possible through an AMC donation. As part of its end-of-year activities, for three years in a row now, AMC has organized festivities where children from orphanages, children of police officers who lost their life in the line of duty, and the best pupils of Tirana and SOS village have participated. In the 2006 celebration, the President of the Republic along with other members of government became part of this joyful activity. AMC provided the children with many gift packages and with shows organized especially for them.

On December 1, 2006 AMC joined other institutions, organizations, individuals, and partners in the fight against AIDS, or as the former Secretary General of the United Nations, Kofi Annan, calls it “the greatest challenge of our generation”. The company’s employees wore the red ribbon commemorating the World AIDS Day, and gave their financial contributions in the AMC offices and shops. The amount raised was used to help HIV infected children in Albania.

On November 23-25, 2006 officials from the Central European Initiative (CEI) — created 17 years ago to strengthen ties between the region and the European Union — and representatives from international institutions gathered in Tirana. Albania held the organization’s annual rotating presidency. The summit followed an economic forum attended by about 900 business leaders from participating countries who discussed reforms and investments for stimulating business development, competitiveness, and entrepreneurship in Eastern and Central Europe. The forum, together with the round table of the Prime Ministers and Ministers of Economy of the participating countries and the concluding summit, were the three major components of the activity. Being conscious on the importance of the initiatives, AMC was an important contributor of this event.

Kjo revistë ka si qëllim të pasqyrojë imazhin e vërtetë të NATO-s si organizatë, arritjet e saj, vlerat, opinionet, çështjet e integritetit të Shqipërisë dhe gjithashtu të ofrojë informacion mbi çështje të ndryshme të sigurisë dhe punëve publike. Revista do të jetë botim i përtremuajshëm.

AMC mbetet e përkushtuar për të investuar për të mirën sociale të komunitet. Në rrugën e saj të vazhdueshme drejt një Përgjegjëshmërie Sociale të shëndoshë, ajo ka vepruar si katalizator për nisma dhe ndryshim.

## Carrie AUER

Përfaqësuese e UNICEF-it për Shqipërinë - UNICEF Representative for Albania

“Në emër të Zyrës së UNICEF-it në Shqipëri, do të doja t’ju falenderoja për donacionin dhe mbështetjen që AMC ka dhënë në fushatën e informimit publik mbi të drejtat e fëmijëve në Shqipëri. Fushata ishte shumë e rëndësishme, pasi krijoi një mundësi të shkëlqyer për sensibilizimin e shoqërisë dhe promovimin e një kulture mirëkuptimi dhe respekt për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri. Gjithashtu mbetet shumë e rëndësishme që të punojmë së bashku për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në vend.

Ju falenderoj edhe një herë për ndihmën tuaj të çmuar.”

In December 2006, with the support of NATO and AMC, the Institute for Democracy and Mediation has published the first edition of the “Security Issues” magazine. This magazine aims at portraying the true image of NATO as an organization, its achievements, values, opinions, Albania’s integration affairs and also offering information on various security and public affairs issues. The magazine will be quarterly publication in Albania.

AMC remains committed to social investment in the community. The company embraces the responsibility of being a catalyst for change and embarks on a continuous journey to lead the way in corporate social responsibility.

“On behalf of UNICEF Albania I would like to thank you for the donation and the support AMC has given for the public information campaign on children’s rights in Albania. The campaign was very significant as it created a great opportunity to raise awareness and promote a culture of understanding and respect for children’s rights in Albania. It is therefore of paramount importance that we work together towards advocating for the realization of children’s rights in the country.

Thank you for your invaluable assistance.”



## Mjedisi

Si pjesë e përkushtimit të AMC-së ndaj komunitetit, kompania ka vendosur të kontribuojë në mjedis nëpërmjet disa projekteve. Investimet për parqe, hapësira të gjelbra dhe kënde lojërash janë të nevojshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sipërfaqeve të gjelbra në Shqipëri. Këto hapësira përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë, si dhe krijojnë një mjedis të shëndetshëm për brezat e ardhshëm.

Angazhimi i AMC-së ndaj mjedisit është i dukshëm nëpërmjet nismës për të mbështetur projektin e Bashkisë së Durrësit në rindërtimin e parkut në Portin e këtij qyteti. Parku është hapësira e parë e blertë që përshëndet vizitorët të cilët mbërrijnë me linjat e përditshme, në port.

Kontributi i AMC-së në shtimin e hapësirave të gjelbra nuk kufizohet vetëm në metropol, por prek edhe zonat e largëta. Objektivat e zhvillimit të AMC-së shtrihen në të gjithë vendin, pa u dhënë përparësi selektive zonave urbane në krahasim me ato rurale. Gjatë vitit 2006, AMC ka mbështetur një nismë të Bashkisë së Himarës, duke kontribuar në krijimin e një parku lojërash. Parku është bërë një nga vendet më të dashura për zbatimin e fëmijëve të komunitetit.

AMC kontribuon jo vetëm përmes burimeve financiare, por edhe duke mbështetur fuqizimin e institucioneve dhe organizatave, me qëllim përmirësimin e funksionimit të tyre në të ardhmen. AMC ka bashkëpunuar me autoritetet vendore të Njësisë Bashkiake II, duke siguruar buldozerë dhe kamionë të rëndë për mirëmbajtjen e rrugëve, hapësirave të gjelbra dhe sistemit të kanalizimeve. Kjo pjesë e qytetit ka rreth 60 mijë banorë dhe është një nga zonat më të populluara në kryeqytet.

## Të mësuarit dhe arsimit

Duke marrë parasysh kohët e vështira që ka kaluar sistemi i arsimit në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit, AMC ka ofruar mbështetjen e saj për arsimin në Shqipëri në të gjitha nivelet.

Nismat që AMC ka ndërmarrë në fushën e arsimit e kanë origjinën në besimin e patundur se çdo fëmijë shqiptar meriton një shans të barabartë në jetë dhe se hapi i parë

## Environment

As part of AMC's commitment to the community, the company has chosen to contribute to the environment through several projects. Investments for parks, green lands and playgrounds are necessary for maintaining and improving green spaces in Albania. These spaces enhance the quality of life for Albanian citizens as well as create a healthy environment for the future generations.

AMC's commitment to the environment is evident through its initiative to sponsor the Municipality of Durres project to re-establish the park at the Port of Durres. The park is a green space with plenty of trees that greets visitors coming out of the Port.

AMC's contribution in enhancing green spaces is not limited to metropolitan venues but also targets remote areas as well. AMC prides itself in having goals of development for all parts of the country, without selectively prioritizing urban over rural areas. During 2006 AMC supported an initiative of the Municipality of Himara by funding the establishment of an amusement park. The park is easily accessible and has become one of the most frequented and lovable places for children's entertainment in the community.

AMC seeks not only to fund through resources but also to empower institutions and organizations to better their operations for the future. AMC has collaborated with the local authorities of Unit II of the Municipality of Tirana, providing them with bulldozers and heavy duty trucks to maintain the streets, green spaces, and canalization system. This part of the city accounts for sixty thousand inhabitants and is one of the most populated areas of the capital.

## Learning and Education

Taking into consideration the difficult times that the Albanian education system has experienced through the period of transition, AMC has committed its support for Albanian education at all levels.

The rationale behind AMC's education-related initiatives originates from its firm belief that every Albanian child deserves an



drejt ndryshimit të së ardhmes është formimi i brezit të ri nëpërmjet një arsimit të cilësisë të lartë. Aktivitetet e AMC-së në këtë fushë kanë mbështetur studentët dhe shkollat në të gjithë Shqipërinë, ku janë përfshirë që nga fëmijët e kopshteve deri te të rinjtë. Gjithashtu, partneriteti dhe bashkëpunimi me institucionet profesionale të kësaj fushe, siç janë Ministria e Arsimit dhe UNICEF-i, ka rezultuar i suksesshëm.

Një projekt i sapo nisur në fushën e arsimit është projekti “Shqipëria lexon”. Projekti 3-vjeçar, i iniciuar nga UNICEF-i dhe i mbështetur fuqishëm nga AMC, synon të pajisë me biblioteka çdo shkollë të vendit. Institucionet e përzgjedhura përfshijnë shkolla fillore, nëntëvjeçare dhe të mesme në të gjithë Shqipërinë.

Më 9 maj 2006, studentët e shkollave të mesme të Tiranës dhe ato të Milanos, morën pjesë në aktivitete të ndryshme në kuadër të Ditës Evropiane. Studentët e shkollave të mesme të Tiranës ishin pjesë e performancës “Rrugët drejt Evropës” të organizuar nga Qendra Evropiane e Shkollës, Edukimit dhe Shoqërisë, BE, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria Arsimore e Tiranës. AMC ishte mbështetësja kryesore e këtij aktiviteti.

E ndjeshme ndaj nevojave të studentëve në rrugën e tyre drejt arsimimit të mëtejshëm, AMC është nismëtarja e “Bursave të AMC-së”, që tashmë janë kthyer në një traditë për të pestin vit radhazi. “Bursat e AMC-së” mbështesin financiarisht 15 nxënës të diplomuar me rezultatet më të mira në shkollat e mesme dhe që kërkojnë të vazhdojnë studimet universitare. Qëllimi i këtij programi është rritja e cilësisë së të mësuarit, nxitja dhe promovimi i vlerave më të mira si dhe krijimi i një baze të qëndrueshme në shërbim të sektorit publik dhe privat.

Shoqata Ndërkombëtare e Filozofisë Greke organizoi në prill 2006 “Simpoziumin e Parë të Filozofisë Greke” me pjesëmarrjen e akademikëve dhe shkencëtarëve të njohur nga Shqipëria dhe Greqia. Në këtë simpozium pjesëmarrësit diskutuan për filozofinë e antikitetit grek, veprat e tyre dhe efektin që kanë sot në mendimin njerëzor. AMC, si mbështetësja kryesore e aktivitetit, dha në këtë mënyrë, kontributin e saj në zhvillimin akademik dhe shkëmbimin kulturor ndërmjet vendeve.

equal chance in life and that the very first step towards changing the future is to equip the next generation with top-quality education. AMC's activities in this field have assisted students and schools all over Albania. AMC has provided support for students ranging from kindergarten children to young adults. Success has also resulted from AMC's close partnership and cooperation with field-professional institutions such as the Ministry of Education and UNICEF.

A recently launched project in the field of education is called “Albania Reads”, The three-year project initiated by UNICEF and vigorously supported by AMC seeks to provide a library for every school in the country. Identified institutions include elementary, middle and high schools all over Albania.

May 9, 2006 Tirana and Milan high school students simultaneously participated in various activities in the frame of the European Day. Tirana high school students were part of the “Ways to Europe” performance. The European Centre of School, Education, and Society, CE, Ministry of Education and Science, and Tirana Directorate of Education were the organizers, while AMC was the main supporter of this activity.

Receptive to the needs of students in their leap towards higher education, AMC is a proud and sole carrier of the “AMC Scholarships” initiative, now a tradition in its 5th consecutive year. “AMC Scholarships” provide financial support for the 15 students with the best academic performance who have graduated from high school and seek university education. This program aims to improve education quality, to encourage and promote the best values and to establish sustainable bases which will serve to the public and private sector.

The International Association of Greek Philosophy organized the “1st Symposium of Greek Philosophy” with the participation of well-known academics and researchers from Albania and Greece in April, 2006. In the symposium the participants discussed the ancient Greek philosophers, their philosophies and the effect they have on human thought today. AMC was the main supporter of this symposium, contributing to the academic development and the cultural exchange between the countries.

AMC mbetet e përkushtuar të japë mbështetjen e saj në të gjitha nivelet, sapo studentët shqiptarë hyjnë në dyert e universiteteve. Universiteti Politeknik i Tiranës ishte objektivi i një nisme të spikatur të AMC-së, duke siguruar mbështetje logjistike për klasat dhe mjediset e tjera të këtij institucioni. E vetëdijshme për rëndësinë e dijeve, kujdesi i kompanisë për studentët i ka kapërcyer kufijtë gjeografikë. Në bashkëpunim me organizatat e studentëve, si Rrjeti i Studentëve Shqiptarë (ASAN), në vitin 2006, AMC së bashku me disa institucione qeveritare dhe disa nga bizneset më të mëdha, krijuan mundësi praktike për punësimin e 150 studentëve shqiptarë që studiojnë jashtë, por kërkojnë të trajnohen profesionalisht në vendin e tyre.

Në lidhje me arsimin, AMC përballet me më shumë sfida në vitet që vijnë. Shkalla e të arsimuarve ka rënë gjatë viteve të fundit në Shqipëri dhe shumë nxënës në zonat rurale po braktisin shkollën fillore dhe 9 vjeçare për t'u punësuar për shkak të kushteve të vështira të jetës. Kompania, nëpërmjet programeve dhe iniciativave shpreson të ofrojë një zgjidhje në të ardhmen, për këtë problem gjithnjë e në rritje.

## Edlira ÇEPANI

ASAN – Drejtoreshë Ekzekutive - ASAN – Executive Director

“Rrjeti i Studentëve Shqiptarë në Botë (ASAN)” ka pasur një bashkëpunim të ngushtë dhe të vlefshëm me AMC-në gjatë verës së vitit 2006 në zbatim të projektit “Praktikë 2006 – Rikthim dhe Punësim”. Ky projekt, i iniciuar në kuadër të strategjisë kombëtare për thithjen e trurit, u ofroi më shumë se 200 mundësi praktike studentëve shqiptarë, të cilët aktualisht po studiojnë jashtë vendit. Shumëllojshmëria e pozicioneve të ofruara përfshiu administratën publike, agjencitë qeveritare dhe bizneset private. Rrjeti i Studentëve Shqiptarë në Botë (ASAN) vlerëson kontributin e frytshëm që AMC ka ofruar duke mbështetur nismat e fundit të rrjetit, me synim njohjen e potencialit të të gjithë studentëve shqiptarë, të cilët aktualisht jetojnë jashtë dhe njohjen e tyre me mjedisin e punës në Shqipëri. Pa ndihmën e AMC-së, zbatimi i projekteve të tilla nuk do të ishte i mundur.”

As Albanian students reach the doors of universities, AMC maintains its commitment of support at all levels. The Polytechnic University of Tirana was the target of a landmark initiative from AMC providing logistics support for classrooms and other institution premises. Akin to knowledge, the company's concern for students does not recognize geographical boundaries. In cooperation with student organizations such as the Albanian Students Abroad Network (ASAN), in the summer of 2006, AMC together with several government institutions and some of the largest private businesses provided internship opportunities for 150 Albanian students who study abroad but seek professional career training in their home country.

In respect to education AMC faces more challenges in the years to come. The literacy rate has dropped in Albania in the past few years, and many students in rural zones are dropping out of elementary and middle schools to eke out a living in poor conditions. It is the company's hope to be able to offer a solution for this growing problem through programs and initiatives in the future.

“The Albanian Students Abroad Network (ASAN) has enjoyed a close and valuable cooperation with AMC during the summer of 2006 in implementing the “Internship 2006 – Rikthim&Punësim” project. This project, carried out in the framework of the “Brain Gain” national strategy, offered more than 200 internship opportunities to Albanian students who are currently studying outside the country. The variety of positions held included public administration, governmental agencies and private businesses. ASAN appreciates the fruitful contribution that AMC has offered in the network's latest initiatives, aimed at recognizing the potential of all Albanian students who currently live abroad, and preparing for the developing Albanian job environment. Without the help of AMC, the implementation of such projects would not have been possible.”



## Sport

E ndërgjegjshme për rëndësinë që ka sporti për shëndetin e qytetarëve, AMC i qëndron besnike kontributit të saj të vazhdueshëm në zhvillimin e sporteve në Shqipëri. Në vitin 2006, ky kontribut pati një pamje dy dimensionale, nga njëra anë mbështetja që AMC ofroi për zhvillimin e sporteve profesionale dhe nga ana tjetër vëmendja që ajo i kushtoi promovimit të kulturës së sporteve në të gjithë vendin. Objektivat në këtë fushë, AMC i ka realizuar me sukses nëpërmjet nismave të saj dhe partneritetit me disiplinat respektive, federatat kombëtare dhe institucione të tjera.

Në përpjekjen e saj për të kontribuar në zhvillimin e sporteve profesionale në Shqipëri, AMC mbështeti "Turin e hapur të volejbollit në plazh 2006, AMC – FSHV" dhe "Kampionatin Ballkanik të volejbollit në plazh". Në këtë të fundit merrnin pjesë skuadra nga Rumania, Bullgaria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Greqia. 45 orë lojërë në katër qytete të ndryshme, të ndjekura nga mijëra tifozë e kthyen këtë aktivitet në një ngjarje të rëndësishme për vitin 2006 dhe një tjetër mision të kryer nga AMC.

Mbështetja e AMC-së për pesë anëtarët e Skuadrës Kombëtare të Gjumnasteve është një tjetër shembull i përkushtimit të saj për të nxitur atletet profesionale shqiptare. AMC i mbështet ato jo vetëm gjatë trajnimit, por bën të mundur edhe pjesëmarrjen e tyre në turne ndërkombëtare. Me mbështetjen që i jep Federatës Shqiptare të Gjumnastikës, AMC kontribuon në formimin e kampionëve të ardhshëm.

AMC, gjatë vitit 2006, mbështeti gjithashtu turneun e 63-të çiklistik një nga ngjarjet më të vjetra në Evropë. Turneu filloi me 24 shtator me 70 çiklistë nga 11 skuadra shqiptare, që ndoqën një rrugë prej 75 km në 7 etapa. Për herë të parë, në garën e vitit 2006, përveç skuadrave nga Kosova dhe Serbia, mori pjesë dhe një skuadër gjermane.

Promovimi i kulturës së sportit në Shqipëri është vetëm një aspekt më shumë i Përgjegjshmërisë Sociale të AMC-së. Më 1 Qershor, ditën ndërkombëtare të fëmijëve, AMC

## Sports

Aware of the importance sports plays in creating a healthier citizens, AMC remains faithful to continuously contributing in the development of sports in Albania. In 2006 AMC's contribution to sports has a two dimensional face, one being the support offered for the development of professional sports, and the other being the concern for a nationwide promotion of the culture of sports in the country. These goals have been set and successfully carried out through several initiatives either from AMC alone or in partnership with the respective disciplines, national federations and other institutions.

In its endeavor to contribute to the development of professional sports in Albania, AMC sponsored the "AMC-FSHV Beach Volley Open Tour 2006." The beach volley tournament had a regional perspective as it was divided into two parts; the national tournament and "Balkan 2006" with the latter involving teams from Romania, Bulgaria, FYROM, and Greece. Forty-five hours of games in four different cities, viewed by thousands of fans, made the event a sports milestone for 2006 and another mission accomplished for AMC.

AMC's support for the five members of the Female National Gymnastic Team is another example of its commitment to encouraging Albanian professional athletes. AMC supports them not only during training but enables their participation in international tournaments as well. AMC is sustaining the Albanian Gymnastic Federation by helping to create the champions of future generations.

AMC also supported the 63-th Tour of Albania cycling race, one of the oldest sports events in Europe. The tour started on September 24, with 70 riders of 11 Albanian teams that rode for 75 km in seven stages. For the first time, apart from teams from Kosovo and Serbia, a German team also participated in the 2006 race.

Promoting a sports culture in Albanian is just one more aspect of AMC's commitment to social responsibility. International Children's Day, June 1st, saw AMC in close cooperation with



në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, organizuan një panair sportiv me pjesëmarrjen e qindra fëmijëve, të cilët ushtruan sporte të ndryshme në kampionate të improvizuar.

Kultura sportive kultivohet në moshat e reja, por angazhimi duhet ndjekur më tej edhe me moshat e rritura. Bazuar në këtë koncept, "ALBAKARTA Minifutboll", pjesë e një tradite dy vjeçare, ishte gjithashtu një nismë e suksesshme e AMC-së, që bashkoi qindra futbollistë amatorë në një kampionat, i cili u zhvillua në 4 qytete me pjesëmarrjen e 128 skuadrave.

Mbështetja e plotë e AMC-së në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Federatës së Atletikës, mundësoi Maratonën "Nënë Tereza" 2006 në Tiranë. Atletët të grupmoshave të ndryshme konkurruan në kategoritë e tyre. Me interes të veçantë ishte pjesëmarrja e atletëve veteranë, të cilët arritën ta bënin këtë një ngjarje të veçantë.

Këto dhe shumë aktivitete të tjera janë pjesë e angazhimit të AMC-së për promovimin e sportit shqiptar, amator dhe profesionit, si një mënyrë inkurajimi për një mënyrë jetese më të shëndetshme.

#### **Dita e Verës**

Kjo festë shqiptare është simbol i mbarimit të dimrit dhe fillimit të verës. Ajo është festë tradicionale e Elbasanit, por tani festohet në të gjithë vendin. AMC ka marrë pjesë duke mbështetur disa aktivitete si:

- Një garë verore me nxënësit e shkollës 8-vjeçare të Komunës Bradashesh
- Një koncert me muzikë bashkëkohore të luajtur nga artistë të rinj të famshëm shqiptar në një skenë të lëvizshme në qendër të qytetit.

Gjatë Ditës së Verës AMC e ka shtrirë pjesëmarrjen e saj edhe në kryeqytet, duke mbështetur një koncert të organizuar nga Bashkia e Tiranës.

the Ministry of Education; organize a children's sports fair which involved hundreds of children playing several sports as part of improvised championships.

A sports culture is cultivated from the early years but the commitment should be followed through into the adult years as well. Based on this concept, the "ALBAKARTA Mini-football", part of a tradition in its second year, was yet another successful AMC initiative by bringing together hundreds of amateur footballers in a championship that took place in 4 cities with a total of 128 participating teams.

The full support of AMC in collaboration with the Ministry of Tourism, Culture, Youth, and Sports and the Federation of Athletics made possible the 2006 Marathon of People "Mother Teresa" in Tirana. Runners of various age groups competed in their own race categories. Of particular interest were the athletic veterans that succeeded in making this a very interesting event.

These and many other activities are part of AMC's commitment to promoting Albanian sport throughout its development, both with amateurs and professionals all as a way of encouraging a healthier lifestyle.

#### **Summer Day**

This Albanian holiday is a symbol of the end of winter and start of summer. It was traditionally founded in Elbasan but now is celebrated all over the country. AMC participated by supporting a variety of activities such as:

- Summer race with secondary school pupils of Bradashesh Commune
- A Concert of contemporary music sound performed by famous young Albanian artists on a mobile stage in the city square.

AMC expanded its participation in Tirana with Summer Day celebrations by supporting a concert organized by the Municipality.

#### **Kultura dhe Artet e Bukura**

Ruajtja e trashëgimisë kulturore kombëtare është një detyrim moral për çdo anëtar të shoqërisë sonë, individualisht dhe në mënyrë kolektive. AMC është e përkushtuar të mbështesë nisma që promovojnë kulturën dhe artet shqiptare, si në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Një kontribut i ndjeshëm është dhënë për organizimin e ngjarjeve artistike, duke inkurajuar të rinjtë e talentuar në fusha të tilla si letërsi, muzikë dhe arte vizive për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të pasur një vend ku ata të shfaqin talentin. Aktiviteti ynë në këtë fushë gjithashtu ka si qëllim ruajtjen e trashëgimisë së rrallë kulturore kombëtare dhe përkrahjen e nismave për promovimin e saj, si në vend, ashtu edhe jashtë tij.

#### **Panairi i Librit**

Duke e konsideruar librin si simbol të mësimin dhe dritare të diturisë, AMC ka kërkuar mënyra për ta komunikuar këtë mesazh të gjithë grupmoshat në Shqipëri. Shoqata e Botuesve Shqiptarë dhe Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Pjetër Arbërori", në bashkëpunim me AMC-në organizoi Panairin e Nëntë në Tiranë, i cili arriti kulmin me një ceremoni, ku u ndanë çmime për shkrimtarin, përkthimin, kopertinën, ilustrimin dhe shtëpinë botuese më të mirë. AMC dhe UNICEF kanë dhënë çmimin Libri më i Mirë i Vitit 2006 për Fëmijë.

#### **Arti bashkëkohor ndërkombëtar në Tiranë**

AMC ka qenë promovuesi i një prej ngjarjeve më të rëndësishme të skenës së arteve vizive. "Tirana Expo Art" ka qenë një nga vitrinat për promovimin e veprave më të rëndësishme të artit shqiptar. Çmimi Bashkëkohor i AMC-së u jepet artistëve të rinj të talentuar që jetojnë në Shqipëri. Ekspozitë e artistëve përfshin një shumëllojshmëri të shprehjes së arteve bashkëkohore, përfshi video, fotografinë, pikturën, skulpturën, performancën dhe tekstin.

#### **Fine Arts and Culture**

The preservation of the nation's cultural heritage is a moral obligation for each member of our society, both individually and collectively. AMC is dedicated to supporting initiatives that promote Albanian culture and arts, both nationally and internationally. A large donation has gone to artistic events encouraging talented young Albanians in such fields as literature, music and visual arts to hone their skills and have a venue to show their works. Our activity in the area is also aimed at safeguarding the spectacular national cultural heritage of the Albanian people and supporting initiatives for its promotion both at home and abroad.

#### **Book Fair**

AMC considers the book to be the symbol learning and window to knowledge. So we look for ways to convey this message to all group ages of Albanians. The Albanian Publishers Association and the International Center of Culture "Pjetër Arbërori", in partnership with AMC, organized the 9th annual book fair in Tirana which climaxed with an awards ceremony with prizes for best writer, translation, book cover, illustration and stall. AMC and UNICEF have awarded the prize Best Children's Book of Year 2006.

#### **Tirana International Contemporary Art**

AMC has been the promoter of one of the most important events of the Albanian visual arts scene. "Tirana Expo Art" has been a showcase for the most prominent examples of Albanian art and provides a canvas to promote works for eventual offer in the market. The AMC Contemporary Prize is awarded to talented young artists living and working in Albania, with an exhibition of the artists that include a multiplicity of contemporary art expressions including video, photography, painting, sculpture, performance and text.



### Akademia Kult

Ruajtja dhe pasurimi i trashëgimisë kulturore shqiptare ishte motoja e ceremonisë së 12-të të çmimeve të Akademisë Kult që mbahet çdo vit – një urë komunikimi ndërmjet artistëve dhe publikut, që promovon vlerat më të mira në art, letërsi, balet dhe aktrim. Sërish, AMC ofroi mbështetjen e saj për këtë nismë të çmuar.

### Kënga Magjike

Duke krijuar traditën e saj në sjelljen e muzikës bashkëkohore shqiptare si një alternativë në festivalet tradicionale, “Kënga Magjike” ka nxjerrë në pah këngëtarë, shumë prej të cilëve kanë dalë në skenë për herë të parë. Që prej fillimit të saj, në vitin 1999, “Kënga magjike” është bërë një nga ngjarjet më të rëndësishme të vitit.

### Festivali “Shopen” për piano

Me mbështetjen e AMC-së, shoqata ‘Frederik Shopen’ organizoi Festivalin e V-të të Shopenit. Ky festival ka fituar tashmë reputacionin si një ngjarje e rëndësishme muzikore në Tiranë. AMC është një mbështetëse e vazhdueshme e aktiviteteve të tilla interesante që kontribuojnë në pasurimin e jetës artistike.

### Eurovizioni

Të gjithë këngëtarët shqiptarë që kanë konkurruar për tre vite me radhë, në Eurovizion, duke përfshirë edhe Anjeza Shahinin e cila arriti pozicionin më të lartë, në vend të 7-të, kanë patur mbështetjen e AMC-së. Teleshikuesit shqiptarë patën mundësi ta ndjekin festivalin dhe të japin tele-votën e tyre për këngën e preferuar.

### Fest Folku Sofra Dardane

Festivali më i madh i mbajtur në territorin Dardan u organizua në Tropojë, me 16 – 18 qershor me 352 pjesëmarrës nga shumë qendra kulturore të veriut të Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi, të mbledhur për të shfaqur vlerat që përfaqësojnë këngët e tyre. Organizatorët e quajtën Fest Folk Sofra Dardane me qëllim ruajtjen e traditës së vjetër unike për këto teritore, tradite e cila portretizohet nëpërmjet muzikës. AMC ishte mbështetësjë kryesore në këtë aktivitet, i cili shfaq disa nga trashëgimitë më të mira të kulturës shqiptare.

### Kult Academy

Preserving and enriching Albanian cultural heritage was the motto of the 12th annual prize ceremony of the Kult Academy – a communication bridge between artists and public that promotes the best in art, literature, ballet, and acting. Again, AMC offered its support for this valuable initiative.

### Magic Song

Building on its tradition of bringing contemporary Albanian music as an alternative to the traditional festivals, “Magic Song” featured several singers, many of them appearing for the first time on stage. Since its first staging in 1999, it has become one of the most anticipated events of the year.

### “Chopin Festival” Piano

Generously supported by AMC, the Frederic Chopin Association put on the Chopin Festival which has now earned a reputation as an important musical event in Tirana. AMC is a constant supporter of such interesting activities that contribute to the enrichment of the artistic life.

### Eurovision

All Albanian singers participating in the Eurovision Song Contest for three consecutive years have had the generous support of AMC, with Anjeza Shahini's seventh place as reaching the highest ranking. Albanian viewers were able to watch the festival and cast their tele-vote for their favorite song.

### Fest Folk of Dardane Mahogany

The largest Folk Festival held in Dardane territory was organized in Tropoja June 16-18 with 352 participants from many cultural centers of North Albania, Kosovo and Montenegro gathered to display the values their songs represent. Its organizers named it the Fest Folk of Dardane-Mahogany with the aim to preserve the ancient traditions unique to these territories as portrayed through music. AMC was the main supporter for this activity which displays some of the best of Albania's cultural heritage.





### Çmimi i madh Euro Video – Euro Video Grand Prix

Kjo ngjarje e madhe artistike u organizua në Tiranë me 3 qershor 2006. 27 këngë që përfaqësonin 27 kombe morën pjesë në Euro Video Grand Prix 2006, i pari i këtij lloji. Aktorja e Hollywoodit me prejardhje shqiptare Eliza Dushku e cila përshëndeti pjesëmarrësit dhe festivalin, ishte e ftuara speciale e kësaj ngjarjeje. Edhe një herë AMC, mbështetëse e këtij aktiviteti, dha kontributin e saj në promovimin e vlerave kulturore shqiptare në Evropë.

### Euro Video Grand Prix

This great artistic event was organized in Tirana June 3rd, 2006. 27 songs representing 27 nations participated in the European Video Grand Prix 2006, the first of its kind. The Hollywood actress of Albanian ancestry Eliza Dushku was the special guest of this event, who saluted the participants and the festival. Once more, AMC the supporter of this activity has contributed to promote the Albanian cultural values within the European region.





## 7 Vizioni Ynë për të Ardhmen Our Vision for the Future

### Vizioni ynë për të ardhmen

Pas 10 vjetësh kontribut në shoqëri, ekonomi dhe mjedis, AMC do të vazhdojë të konsolidojë filozofinë e saj për veprime të përgjegjshme sociale, me të njëjtin përkushtim, interes dhe dëshirë. Qëllimi i AMC-së është të vazhdojë të japë kontributin e saj për zhvillimin e shoqërisë dhe mjedisit shqiptar, ku ajo zhvillon veprimtarinë. Në fushën e Përgjegjshmërisë Sociale, AMC synon të jetë shembull për t'u ndjekur edhe nga kompanitë e tjera. AMC, duke u mbështetur në themelet e hedhura në vite, në marrëdhëniet e saj me partnerët socialë dhe fuqizimin e tyre nëpërmjet praktikave e politikave bashkëkohore, si dhe në strategjinë e saj dinamike të Përgjegjshmërisë Sociale, ka krijuar një vizion të qartë për të ardhmen. Për AMC, funksionimi sot si një biznes i përgjegjshëm, do të thotë hedhje e bazave për suksese të mëtejshme.

#### Burimet njerëzore

Kompania ka si qëllim të punësojë, zhvillojë dhe motivojë profesionistët më të mirë. AMC, nëpërmjet menaxhimit të burimeve njerëzore, të orientuar nga biznesi dhe tregu, synon të spikasë me një performancë të shkëlqyer. Ajo do të vazhdojë të ndjekë nga afër vlerësimet dhe shqetësimet e punonjësve në mënyrë që të përshtasë praktikën përkatëse të menaxhimit.

AMC ka si qëllim të përfshijë në një pjesëmarrje të dobishme sektorë të ndryshëm të kompanisë, në krijimin dhe zbatimin e praktikave më të mira të përgjegjshmërisë sociale. Për këtë arsye, AMC ka ngritur sektorin e Përgjegjshmërisë Sociale, një ndër detyrat e të cilit është të sigurojë vënien në jetë të objektivave të kompanisë në këtë fushë si dhe të sigurojë një shkëmbim të dyanshëm të informacionit dhe njohurive lidhur me çështje të kësaj natyre.

### Our Vision for the Future

After ten years of contribution to the society, economy and environment, AMC will continue to consolidate its philosophy about social responsible action into a work of substance with the same determination, eagerness and willingness. AMC's goal is to continue its contribution to the prosperity of the Albanian society and the environment within which it successfully operates. With regard to its social activity, AMC aims to be a model of responsibility that will encourage other companies to become actively involved as well. The company will fully utilize the foundations it has laid in previous years, its relationship with social partners and empower them through contemporary practices, policies and its dynamic strategy of Social Responsibility. AMC has a clear set vision for the future. For AMC, operating a responsible business today means laying the ground for new successes in the future.

#### Regarding Human Resources

AMC aims to hire, develop, motivate and retain the best professionals. AMC seeks to achieve both company and individual excellence through business and market oriented human resources management. AMC will continue to closely monitor employee satisfaction and adjust management practices accordingly.

AMC aims to instill effective participation of the company's operating units in the formation and implementation of the best practices of Social Responsibility. AMC has proceeded with the introduction of a CSR team. This team's goal is to safeguard the implementation of social responsibilities throughout the company's operating units and ensure two-way exchange of information and knowledge in respect to social responsibility issues.



### **Klientët**

AMC do të vazhdojë të ofrojë cilësi, vlera dhe shërbime të shkëlqyera ndaj klientëve të saj, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetës së tyre, si dhe duke e bërë komunikimin të prekshëm nga të gjithë. Një nga qëllimet e AMC-së për vitin e ardhshëm do të jetë afrimi drejt grupeve sociale të ndjeshme në Shqipëri, duke ofruar shërbime të përshtatura me nevojat e këtyre grupeve.

Në bazë të kërkimeve në lidhje me mundësitë dhe fizibilitetin e produkteve dhe shërbimeve të saj, AMC do të ofrojë shërbime të veçanta emergjente për njerëzit me probleme dëgjimi, duke siguruar gjithashtu një komunikim të dyanshëm me shërbimet emergjente.

Kompania do të vazhdojë t'i trajtojë klientët me respektin dhe vëmendjen që meritojnë.

### **Mjedisi**

AMC do të rrisë rolin e saj në menaxhimin dhe uljen e riskut mjedisor në komunitetin, në të cilin ajo kryen biznesin e saj. Duke nxitur nisma dhe fushata që i udhëheqin brezat drejt një ekosistemi të pastër dhe të shëndetshëm, AMC do të bëjë të mundur riciklimin e telefonave celularë dhe aksesorëve të tyre. Brenda mjedisit të punës, AMC do të nxisë punonjësit e saj që të jenë përgjegjës për një mjedis të pastër, si dhe pjesëmarrës, krahas saj, në promovimin e kësaj kulture. AMC do t'i përqendrojë përpjekjet e saj në uljen e konsumit të energjisë dhe ujit, riciklimin e letrës e kartonit dhe minimizimin e lëshimit të dioksidit të karbonit (CO2) dhe gazeve të efektit serë.

AMC do të promovojë gjithashtu zhvillimin e sistemeve të energjisë së padëmshme për mjedisin, duke ofruar efikasitet maksimal, në përpjekjet për të luftuar ngrohjen globale.

### **Regarding Customers**

AMC will continue its genuine efforts to deliver quality, value and excellent services to its costumers in order to enhance their quality of life and continue to make communication available to all inhabitants of Albania. One of AMC's goals for the coming year will be to reach out to sensitive social groups within Albania in order to provide special services customized to the needs of vulnerable social groups as well as make its services available to all people, regardless of their background or abilities.

By conducting research regarding the opportunity and feasibility to develop products and services for people with special needs, AMC will strive to provide services such as special emergency services for people with hearing impairment and ensure the two-way communication with the emergency services.

The company will continue to treat its customers with the invaluable respect that they deserve and with the attention that only a world-class company such as AMC can deliver.

### **Regarding the Environment**

AMC will increase its role in managing and reducing environmental risk in the communities in which it conducts its business. AMC will ensure proper disposal of the mobile telephones from its customers by encouraging initiatives and campaigns that lead a generation to value a clean and healthy eco-system. Within its work environment, AMC will encourage its employees to be stewards of a clean environment as well as participants on the efforts of the company to promote a culture of a safe environment for future generations. In the coming year AMC will concentrate its efforts on reducing energy and water consumption, recycling of paper and cardboard, and minimizing CO2 and greenhouse gas emissions.

### **Furnitorët dhe partnerët**

AMC ruan marrëdhënie të drejta dhe profesionale me furnitorët e saj, bazuar në ndershmëri, besim dhe përkushtim. Kompania do të aplikojë parimet e Përgjegjshmërisë Sociale në procesin e menaxhimit të rrjetit të furnitorëve.

### **Shoqëria**

AMC do të vazhdojë të kontribuojë për shoqërinë shqiptare duke u bazuar në nevojat e saj. Ky kontribut ka si qëllim të rrisë ndërgjegjësimin dhe motivimin për adaptimin e standardeve, të cilat synojnë përmirësimin real të cilësisë së jetesës dhe zgjidhjen e nevojave emergjente të grupeve të veçanta të popullsisë. Për më tepër, duke u mbështetur në rezultatet e kontributeve të mëparshme në shoqëri, kompania do të ketë mundësi të fokusohet në aktivitete efektive, të cilat përbëjnë përparësi për shoqërinë e sotme shqiptare.

AMC do të vazhdojë të nxisë dhe mbështesë zhvillimin e shoqërisë demokratike, duke promovuar pjesëmarrjen aktive në shoqëri dhe shërbimet vullnetare. Kompania do të jetë pjesëmarrëse aktive në përpjekjet e Shqipërisë për t'iu bashkuar familjes së madhe Evropiane.

Prioriteti ynë numër një mbetet njeriu. Ne investojmë në ngritjen e një rrjeti të teknologjisë së lartë me parametrat e nevojshëm për të garantuar një mjedis të sigurtë.

AMC will also promote the development of environmentally conscious energy systems offering superior efficiency, in efforts to combat global warming

### **Regarding suppliers and partners**

AMC strives for fair and professional relationships with its suppliers, based on honesty, trust and commitment. The company will apply its Social Responsibility principles in the supply chain management process.

### **Regarding Society**

AMC will continue to contribute based on the recognized needs of the Albanian society. This contribution will aim to enhance awareness and motivation for the adoption of the standards that relate to a real improvement to quality of life and help in resolving the immediate needs of specific population groups. Furthermore by reviewing the results of the previous contribution to the society, the company will have the opportunity to continuously improve and focus on effective activities that constitute a priority for today's Albanian society.

AMC will continue to encourage and support the development of a democratic society, promoting active civic participation as well as voluntary services. The company seeks to be a dynamic player in paving the road to joining the European Union societies.

Our first priority is human being. We invest through the high technology antennas to ensure friendly environment.







KOMPANIA NR.1 E TELEFONISË CELULARE NË SHQIPËRI  
THE LEADING MOBILE OPERATOR IN ALBANIA

ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS - "Gjergj Legisi" - Laprakë - Tiranë  
Tel.: +355 4 275 000 - 139 FAX: +355 4 257 331 - [www.amc.al](http://www.amc.al)